

DC-FoE\_2024\_14

14 shtator 2025

**Udhëzues i Këshillit të Evropës për  
Kufizimin e Përdorimit të Ligjit Penal për të Kufizuar Lirinë e Shprehjes**

Divizioni për Bashkëpunim për Lirinë e Shprehjes

Përkthimi është bashkëfinancuar  
nga Bashkimi Evropian



Titulli i publikimit origjinal:

LIMITING THE USE OF CRIMINAL LAW TO RESTRICT FREEDOM OF EXPRESSION - A GUIDE TO COUNCIL OF EUROPE STANDARDS

Roli dhe përgjegjësia e Këshillit të Evropës në mbrojtjen e lirisë së shprehjes është nënvizuar në "Parimet e Rejkjavikut për Demokracinë", [Deklarata e Rejkjavikut – Të bashkuar rreth vlerave tona](#).

Riprodhimi i fragmenteve (deri në 500 fjalë) lejohet, përveç për qëllime komerciale, për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmenti të mos përdoret jashtë kontekstit, të mos japë informacion të paplotë ose të mos e mashtrojë në asnjë mënyrë lexuesin lidhur me natyrën, fushën ose përmbajtjen e tekstit. Teksti burim duhet të citohet gjithmonë si vijon: “© Këshilli i Evropës, viti i publikimit”.

Të gjitha kërkesat e tjera që lidhen me riprodhimin/përkthimin e të gjithë ose të një pjese të dokumentit duhet t’i adresohen Drejtorisë së Komunikimit të Këshillit të Evropës (F-67075 Strasbourg Cedex ose [publishing@coe.int](mailto:publishing@coe.int)).

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë përgjegjësi e autorit/autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

Përgatitur nga Peter Noorlander, konsulent i Këshillit të Evropës.

Ky përkthim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Këshillit të Evropës dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Dizajni: Këshilli i Evropës

© Këshilli i Evropës, shtator 2025. Të gjitha të drejtat e rezervuara. I liçencuar në Bashkimin Evropian sipas kushteve të miratuara.

[www.coe.int/freedomofexpression](http://www.coe.int/freedomofexpression)

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

|                                                                                                                                                                          |           |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>I. Hyrje</b>                                                                                                                                                          | <b>4</b>  |
| <b>II. Rreziqet e përdorimit të sanksioneve penale për të kufizuar lirinë e shprehjes</b>                                                                                | <b>5</b>  |
| i. Rreziqet dhe ndikimi i drejtpërdrejt tek individët dhe "mbikëqyrësit publikë"                                                                                         | 6         |
| ii. "Efekti frenues" në shoqërinë në tërësi                                                                                                                              | 8         |
| <b>III. Standardet e Përgjithshme të Këshillit të Evropës mbi përdorimin e ligjit penal për të sanksionuar lirinë e shprehjes: kufizim, qartësi dhe proporcionalitet</b> | <b>9</b>  |
| i. Kufizimi                                                                                                                                                              | 10        |
| ii. Gjuhë e qartë dhe e padykuptimshme                                                                                                                                   | 11        |
| iii. Proporcionaliteti: ligji penal duhet të përdoret në mënyrë të përshtatshme dhe pa teprime                                                                           | 12        |
| <b>IV. Penalizimi i gjuhës së urrejtjes</b>                                                                                                                              | <b>13</b> |
| <b>V. Penalizimi i shpifjes dhe fyerjes</b>                                                                                                                              | <b>18</b> |
| <b>VI. Penalizimi i përhapjes së informacionit konfidencial</b>                                                                                                          | <b>22</b> |
| i. Mbrojtja e sekretit të hetimeve penale                                                                                                                                | 23        |
| ii. Mbrojtja e dokumenteve konfidenciale shtetërore                                                                                                                      | 24        |
| iii. Gazetarë që kërkojnë informacione të "rrjedhura"                                                                                                                    | 24        |
| <b>VII. Penalizimi i fjalës që rrezikon sigurinë kombëtare dhe rendin publik</b>                                                                                         | <b>25</b> |
| <b>VIII. Penalizimi i publikimit të "dezinformimit"</b>                                                                                                                  | <b>27</b> |
| <b>IX. Roli i Këshillit të Evropës në mbështetjen e institucioneve vendase dhe organizatave të shoqërisë civile</b>                                                      | <b>29</b> |

## I. Hyrje

Liria e shprehjes<sup>1</sup> është shtyllë themelore e demokracisë dhe e vlerave të saj thelbësore. Mbrojtja e medias është e nevojshme për shkak të rolit të "mbrojtësit" që ajo luan në shoqërinë demokratike, duke i mbajtur përgjegjës ata që janë në pozita pushteti, duke kontribuar në debatin publik mbi çështje me interes të përgjithshëm dhe duke realizuar të drejtën e publikut për të marrë informacion nga një sërë burimesh, si dhe duke paraqitur një gamë të larmishme mendimesh. E drejta e lirisë së shprehjes mbron fjalën politike, diskutimin mbi çështje me rëndësi publike, shprehjen artistike, informacionin me natyrë komerciale dhe argëtimin siç janë muzika dhe sportet. Ajo mbulon "fjalën", qoftë të folur, me shkrim, në internet apo në transmetim, si dhe akte të tjera shprehëse, të tilla si shfaqjet, protestat, arti, ngritja e skulpturave publike si një formë proteste, madje edhe veshja e rrobave të caktuara.<sup>2</sup> Është e rëndësishme të theksohet se mbrojtja e saj shtrihet në informacione, ide dhe opinione me të cilat shumë njerëz mund të mos pajtohen ose madje t'i konsiderojnë fyese. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Gjykata) ka theksuar:

"Liria e shprehjes ... është e aplikueshme jo vetëm për informacionin apo idetë që pranohen pozitivisht apo vlerësohen si jo ofenduese ose si një çështje e indiferencës, por edhe ndaj atyre që ofendojnë, tronditin apo shqetësojnë Shtetin apo cilindo sektor të popullsisë. Të tilla janë kërkesat e atij pluralizmi, tolerance dhe mendjegjerësie pa të cilat nuk ka 'shoqëri demokratike'".<sup>3</sup>

Mediat luajnë një rol të rëndësishëm në shoqërinë demokratike, duke ushtruar të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes me qëllim përmbushjen e të drejtës së publikut për të marrë informacion dhe ide mbi çështje me interes të përgjithshëm.

Liria e shtypit për më tepër i ofron publikut një nga mjetet më të mira për të zbuluar dhe formuar një opinion për idetë dhe qëndrimet e drejtuesve politikë. Në përgjithësi, liria e debatit politik është në thelb të konceptit të një shoqërie demokratike, e cila mbizotëron në të gjithë Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.<sup>4</sup>

Pavarësisht rëndësisë së saj themelore, Liria e shprehjes nuk është një e drejtë absolute: kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, ajo mund t'i nënshtrohet kufizimeve ose ndëshkimeve të përcaktuara me ligj. Kufizimet mund të vendosen vetëm për mbrojtjen e qëllimeve legjitime të listuara në paragrafin 2 të nenit 10:

- për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike;
- për parandalimin e çrregullimit ose krimit;
- për mbrojtjen e shëndetit apo moralit;
- për mbrojtjen e reputacionit ose të drejtave të të tjerëve;
- për parandalimin e zbulimit të informacionit të marrë në konfidencë; ose
- për ruajtjen e autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit.

---

<sup>1</sup> Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 10(1): Secili ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë.

<sup>2</sup> Për një diskutim mbi zbatueshmërinë e Nenit 10 së bashku me shembuj, shih Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, (2022), [Udhëzues i Nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut](#), f. 12.

<sup>3</sup> [Handyside k. Mbretërisë së Bashkuar](#), kërkesa nr. 5493/72, aktgjykim i 7 dhjetorit 1976, parag. 49.

<sup>4</sup> [Lingens k. Austrisë](#), kërkesa nr. 9815/82, aktgjykim i 8 korrikut 1986, parag. 42.

Kufizime ose dënime mund të përcaktohen sipas ligjit civil, ligjit administrativ ose ligjit penal. Për shkak të natyrës së ashpër të ligjit penal, i cili mund të rezultojë në burgim ose sanksione të tjera të rënda, shtetet duhet t'i drejtohen pak ligjit penal. Kërkesa e 'domosdoshmërisë' do të thotë që kufizimet mund të vendosen vetëm kur ekziston një nevojë e ngutshme shoqërore për ta bërë këtë, për të cilën jepen arsye të konsiderueshme dhe të mjaftueshme.<sup>5</sup>

Ky udhëzues ofron një pasqyrë të përgjithshme të standardeve të të drejtave të njeriut që zbatohen për vendosjen e sanksioneve penale mbi ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes. Ai u drejtohet ligjvënësve, shoqërisë civile, nëpunësve civilë, medias dhe palëve të tjera të interesit të politikëbërësve, duke ofruar një pasqyrë të lehtë për t'u përdorur dhe të arritshme të standardeve të zhvilluara nëpërmjet aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe udhëzimeve të politikave të lëshuara nga organet e Këshillit të Evropës, siç janë Komiteti i Ministrave, Asambleja Parlamentare dhe Komisioni Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit (i njohur si "Komisioni i Venecias").<sup>6</sup>

Ky Udhëzues së pari përcakton rreziqet kryesore që lidhen me përdorimin e ligjit penal për të sanksionuar forma të veçanta të shprehjes, si dhe parimet mbizotëruese të zhvilluara nga organet e Këshillit të Evropës për të zbutur këto rreziqe. Pastaj përqendrohet në pesë fusha të ligjit në veçanti:

- përdorimi i ligjit penal kundër gjuhës së urrejtjes;
- përdorimi i ligjit penal për të mbrojtur reputacionin, nëpërmjet ligjeve për shpifje dhe fyerje;
- përdorimi i ligjit penal për të kufizuar publikimin e informacionit konfidencial;
- përdorimi i ligjit penal për të luftuar propagandën terroriste; dhe
- penalizimi i "dezinformimit" (shpesh i përmendur si "lajm i rremë").<sup>7</sup>

Së fundmi, ky Udhëzues do të përcaktojë rolin e Këshillit të Evropës në mbështetjen e institucioneve vendase dhe organizatave të shoqërisë civile në promovimin e të drejtës së lirisë së shprehjes në përputhje me standardet evropiane.

## **II. Rreziqet e përdorimit të sanksioneve penale për të kufizuar lirinë e shprehjes**

Shoqëria demokratike kërkon që disa forma të sjelljes të penalizohen. Këtu përfshihen vepra të dhunshme si vrasja, rrahja dhe sulmi, si dhe vepra të tilla si vjedhja dhe mashtrimi. Gjithashtu përfshin sjelljen që përfshin ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes. Për shembull, mund të penalizohen gjuha e rëndë e urrejtjes dhe nxitja për dhunë. Mundësia për të përdorur ligjin penal për të kufizuar forma të tilla jashtëzakonisht të dëmshme të fjalës është e pakontestueshme në sistemin evropian të të drejtave të njeriut. Për më tepër, Neni 17 i Konventës Evropiane për të

---


<sup>5</sup> Ky është një parim qendror i jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut sipas Nenit 10. GJEDNJ, (2022), [Udhëzuesi për Nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut](#), f. 23.

<sup>6</sup> Herë pas here bëhet referencë edhe për standardet e zhvilluara nga organe të tjera ndërqeveritare të të drejtave të njeriut, në kuadër të sistemit të të drejtave të njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

<sup>7</sup> Ky Udhëzues nuk ka për qëllim të mbulojë të gjitha fushat e mundshme të penalizimit të shprehjes, të cilat do të përfshinin shkeljet e të drejtave të autorit, rregullimin e pornografisë duke përfshirë luftimin e pornografisë së fëmijëve, të ashtuquajturat "krime kibernetike" siç janë përdorimi i ransomware-it, vjedhja e të dhënave personale, ngacmimi në internet dhe ngacmimi kibernetik, për të përmendur vetëm disa tema. Megjithatë, "parimet e përgjithshme" të përcaktuara në këtë Udhëzues vlejné edhe për ato tema.

Drejtat e Njeriut (Konventa) përjashton çdo përdorim të së drejtës së lirisë së shprehjes që mund të dëmtojë të drejtat e mbrojtura sipas Nenit 10.<sup>8</sup>

Megjithatë, përdorimi i ligjit penal për të kufizuar format e tjera të fjalës, më pak të dëmshme për shoqërinë, nënkupton rreziqe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në veçanti, kjo përfshin heshtjen e zërave jopopullorë, kontravers, kritikë ose kundërshtues në shoqëri. Kjo do të shkonte kundër vlerës themelore të pluralizmit që është e natyrshme në të drejtën e lirisë së shprehjes dhe kundër parimeve të shoqërisë demokratike. Në këtë drejtim, është shqetësuese që, sipas të dhënave të mbledhura nga platforma e Këshillit të Evropës mbi sigurinë e gazetarëve,<sup>9</sup> rastet e ndalimit dhe burgosjes së gazetarëve janë rritur ndjeshëm që nga viti 2019.



### i. Rreziqet dhe ndikimi i drejtpërdrejtë tek individët dhe "mbikëqyrësit publikë"

Përmes jurisprudencës së saj, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka identifikuar rreziqe të shumta të shkaktuara nga përdorimi joproporcional i ligjit penal që kufizoi lirinë e shprehjes, jo vetëm për individët e përfshirë në këto raste, por edhe për shoqërinë. Për individët, rreziku i dukshëm ka të bëjë me sanksionin e vendosur. Privimi i lirisë, nëpërmjet ndalimit dhe burgimit, dhe vendosja e gjobave të rënda janë një barrë e qartë për individin që merr një dënim të tillë. Duke pasur parasysh rolin thelbësor të medias, OJQ-ve dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut në shoqërinë demokratike, meqenëse ata i mbajnë përgjegjësitë që janë në pushtet, Gjykata ka theksuar veçanërisht ndikimin e sanksioneve mbi të ashtuquajturit "mbikëqyrës publikë".<sup>10</sup>

Gazetarët hulumtues mund të ndalohen të raportojnë për çështje me interes të përgjithshëm publik (...) nëse rrezikojnë, si një nga sanksionet standarde të vendosura për sulme të pajustificuara ndaj reputacionit të individëve privatë, dënimin me burgim ose ndalimin e ushtrimit të profesionit të tyre. Efekti frenues që frika nga sanksione të tilla ka në ushtrimin e lirisë së shprehjes gazetareske është i dukshëm.<sup>11</sup>

Gjykata ka vendosur që edhe sanksionet e lehta financiare, vetëm 1 euro, ose vendosja e dënimeve me kusht, mund të kenë një ndikim serioz në ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes. Në rastin e dënimeve me kusht, kjo ndodh sepse dënimi qëndron mbi kokën e individit si shpata e Damokleut: gazetari që ka marrë një dënim me kusht do të shmangë raportimin mbi çështje të diskutueshme nga frika se mos bie ndesh me ligjin. Gjykata ka vënë re, në lidhje me

<sup>8</sup> Neni 17 i Konventës (Ndalimi i abuzimit me të drejtat) thotë: "Asgjë në këtë Konventë nuk mund të interpretohet si e drejtë që i jep ndonjë shteti, grupi ose personi për t'u angazhuar në ndonjë aktivitet ose për të kryer ndonjë akt që synon shkatërrimin e ndonjë prej të drejtave dhe lirive të përcaktuara këtu ose kufizimin e tyre në një masë më të madhe se sa parashikohet në Konventë."

<sup>9</sup> Platformë për të promovuar mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve: <https://fom.coe.int/en/accueil>.

<sup>10</sup> Siç theksohet në raste të tilla si *The Sunday Times k. Mbretërisë së Bashkuar* (nr. 2), kërkesa nr. 13166/87, aktgjykimi i datës 26 nëntor 1991, paragrafi 50; *Animal Defenders International k. Mbretërisë së Bashkuar* [GC], kërkesa nr. 48876/08, aktgjykimi i datës 22 prill 2013, paragrafi 103; *Medžlis Islamske Zajednice Brčko dhe të tjerët k. Bosnje dhe Hercegovinës* [GC], kërkesa nr. 17224/11, aktgjykimi i datës 27 qershor 2017, paragrafi 86; *Taner Kılıç k. Turqisë* (nr. 2), kërkesa nr. 208/18, aktgjykimi i datës 31 maj 2022, paragrafi 147; *Magyar Helsinki Bizottság k. Hungarisë* [GC], kërkesa nr. 18030/11, aktgjykimi i datës 8 nëntor 2016, paragrafi 159 dhe 166.

<sup>11</sup> *Cumpănă dhe Mazăre k. Rumanisë*, kërkesa nr. 33348/96, aktgjykimi i 17 dhjetorit 2004, paragrafi 113-114.

raste të tilla, se “dënimi me kusht pati efektin e kufizimit të punës së aplikantes si redaktore dhe zvogëlimit të aftësisë së saj për të ofruar pikëpamjet publike që kanë vendin e tyre në një debat publik, ekzistenca e të cilit nuk mund të mohohet”.<sup>12</sup> Kështu, dënimi me kusht “nga vetë natyra e tij, në mënyrë të pashmangshme do të ketë efekt frenues”.<sup>13</sup>

Në rastin [Brasilier k. Francës](#), Gjykata theksoi ndikimin negativ edhe të një gjobe “simbolike”:

Edhe pse dënimi për “frangën simbolike” është sa më i moderuar të jetë e mundur, Gjykata konsideron se kjo nuk mund të jetë e mjaftueshme, në vetvete, për të justifikuar ndërhyrjen në të drejtën e shprehjes së aplikantit.<sup>14</sup>

Gjykata ishte veçanërisht e vetëdijshme se një “sulm i tillë ndaj lirisë së shprehjes mund të rrezikojë të ketë një efekt dekurajues në ushtrimin e së njëjtës të drejtë”.<sup>15</sup>

Në disa raste që përfshijnë median, Gjykata ka theksuar se natyra penale e një sanksioni është e tillë që edhe një dënim i vogël duhet të konsiderohet si një çështje serioze.<sup>16</sup> Gjykata ka theksuar gjithashtu “pasojat afatgjata, stigmatizuese dhe dekurajuese që çdo shënim në regjistrin penal mund të ketë në mënyrën e punës së profesionistëve të medias, veçanërisht të gazetarëve”.<sup>17</sup> Kjo është përsëritur nga të tjerë. Për shembull, Paneli i Ekspertëve të Nivelit të Lartë për Lirinë e Medias ka paralajmëruar se një dosje penale mund të rezultojë në vendosjen e kufizimeve të vizave, duke e bërë potencialisht të pamundur udhëtimin në vende të caktuara.<sup>18</sup>

Disponueshmëria e një faljeje presidenciale, ose mundësia që burgimi të shndërrohet në gjobë, nuk e fshin dënimin penal.<sup>19</sup> Në [Artun dhe Güvener k. Turqisë](#), Gjykata theksoi, në lidhje me një dënim me burgim që ishte shndërruar në gjobë, se “[e]dhe pse akte të tilla mëshire synojnë sigurisht të lehtësojnë situatën e aplikantëve, ato nuk e fshijnë dënimin e tyre”.<sup>20</sup>

Edhe vetë kërcënimi me ndjekje penale dhe sanksion penal ka një ndikim negativ në ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes.

Gjykata vëren më tej efektin frenues që frika nga sanksioni ka në ushtrimin e lirisë së shprehjes, madje edhe në rast të një lirimi përfundimtar, duke marrë parasysh mundësinë që një frikë e tillë ta dekurajojë dikë nga deklarime të ngjashme në të ardhmen.<sup>21</sup>

Në rastin [Altug Taner Akcam k. Turqisë](#), Gjykata theksoi ndikimin negativ mbi lirinë e shprehjes të fillimit të një hetimi penal dhe të rrezikut real të hetimit për krimin e “denigrimit të turqizmit” në bazë të legjislacionit të hartuar gjerësisht, interpretimi i të cilit nga gjykatat kombëtare ishte i paqartë.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka njohur ndikimin e sanksione penale ndaj anëtarëve të profesioneve për të cilët ushtrimi i lirisë së fjalës është thelbësor, duke përfshirë jo vetëm

---

<sup>12</sup> [Şener k. Turqisë](#), kërkesa nr. 26680/95, aktgjykimi i 18 korrikut 2000, parag. 46.

<sup>13</sup> [Otegi Mondragon k. Spanjës](#), kërkesa nr. 2034/07, aktgjykimi i datës 15 mars 2011, parag. 60.

<sup>14</sup> [Brasilier k. Francës](#), kërkesa nr. 71343/01, aktgjykimi i 11 korrikut 2006, parag. 43.

<sup>15</sup> Po aty.

<sup>16</sup> [Stoll k. Zvicrës \[GC\]](#), kërkesa nr. 69698/01, aktgjykimi i datës 10 dhjetor 2007, parag. 154; [Haldimann dhe të tjerë k. Zvicrës](#), kërkesa nr. 21830/09, aktgjykimi i datës 24 shkurt 2015, parag. 67.

<sup>17</sup> [Artun dhe Güvener k. Turqi](#), kërkesa nr. 75510/01, aktgjykimi i datës 26 qershor 2007, parag. 33.

<sup>18</sup> Paneli i Ekspertëve të Nivelit të Lartë për Lirinë e Medias, (2020), [Raport mbi Ofrimin e Strehimit të Sigurt për Gazetarët në Rrethim](#), parag. 12.

<sup>19</sup> [Cumpăna dhe Mazăre k. Rumanisë \[GC\]](#), kërkesa nr. 33348/96, aktgjykimi i 17 dhjetorit 2004, parag. 116.

<sup>20</sup> [Artun dhe Güvener k. Turqisë](#), kërkesa nr. 75510/01, aktgjykimi i datës 26 qershor 2007, parag. 33.

<sup>21</sup> [Altug Taner Akcam k. Turqisë](#), kërkesa nr. 27520/07, aktgjykimi i datës 25 tetor 2011, parag. 68.

anëtarët e medias ose mbikëqyrësit e tjerë publikë, por edhe avokatët. Në rastin [Nikula k. Finlandës](#), Gjykata vendosi që dënimi për shpifje i një avokati për kritika të ashpra ndaj një prokurori publik në procedurat penale kishte efekt frenues në detyrën e avokatëve për të mbrojtur interesat e klientëve të tyre.<sup>22</sup>

## ii. "Efekti frenues" në shoqërinë në tërësi

Në një nga rastet e para të lirisë së shprehjes para saj, Gjykata pranoi se sanksionet penale kanë ndikim negativ jo vetëm tek gazetarët individualë, por në të gjithë komunitetin gazetaresk dhe madje edhe në shoqërinë në tërësi. Në rastin [Lingens k. Austrisë](#), Gjykata vendosi:

Dënimi i vendosur ndaj autorit ... përbënte një lloj censure, e cila ka të ngjarë ta dekurajonte atë të kritikonte për atë përsëri në të ardhmen ... Në kontekstin e debatit politik, dënimi i tillë ka të ngjarë t'i dekurajonte gazetarët të kontribuonin në diskutimin publik të çështjeve që ndikojnë në jetën e komunitetit. Në të njëjtën mënyrë, sanksioni si ai mund të pengojë shtypin në kryerjen e detyrës së tij si furnizues i informacionit dhe mbikëqyrës publik.<sup>23</sup>

Në rastin [Heinisch k. Gjermanisë](#), Gjykata vendosi në mënyrë të ngjashme se vendosja e një sanksioni të rëndë penal ndaj një sinjalizuesi në një azil pleqsh "jo vetëm që do të kishte pasoja negative në karrierën e aplikantit, por edhe mund të kishte efekt serioz frenues tek punonjësit e tjerë [në të gjithë] sektorin e shërbimit të infermierisë. Ky efekt frenues funksionon në dëm të shoqërisë në tërësi."<sup>24</sup>

Sa më i rëndë të jetë sanksioni, aq më i madh është efekti frenues dhe ndikimi që ka në shoqërinë e gjerë. Në rastin [Şahiner Alpay k. Turqisë](#), Gjykata vuri në dukje:

[P]araburgimi i kujt do që shpreh pikëpamje kritike prodhon një sërë efektesh negative, si për vetë të paraburgosurit ashtu edhe për shoqërinë në tërësi, pasi vendosja e një mase që përfshin heqjen e lirisë, si në rastin aktual, do të ketë në mënyrë të pashmangshme një efekt frenues mbi lirinë e shprehjes duke frikësuar shoqërinë civile dhe duke heshtur zërat kundërshtues.<sup>25</sup>

Gjykata theksoi se ky është rasti "edhe kur i paraburgosuri më pas lirohet nga akuzat".<sup>26</sup> Komisioni i Venecias ka paralajmëruar, kur ka dhënë këshilla mbi një ligj që penalizonte fyerjen e Presidentit, se "dënimet me burgim... kanë shumë të ngjarë të krijojnë një efekt frenues në shoqërinë në tërësi dhe nuk mund të konsiderohen në përpjesëtim me qëllimin legjitim të ndjekur".<sup>27</sup>

Komiteti i Ministrave u bëri thirrje shteteve anëtare që t'i kushtojnë vëmendjen e duhur "efektit frenues" të sanksioneve të së drejtës penale:

---

<sup>22</sup> [Nikula k. Finlandës](#), kërkesa nr. 28274/08, aktgjykim i 21 korrikut 2011, parag. 54. Në rastin [Pais Pires de Lima k. Portugalisë](#), kërkesa nr. 70465/12, 12 shkurt 2019, parag. 67, Gjykata vuri në dukje se sanksione të tilla mund të kenë efekt të dëmshëm në të gjithë profesionin.

<sup>23</sup> [Lingens k. Austrisë](#), kërkesa nr. 9815/82, aktgjykim i 8 korrikut 1986, parag. 44.

<sup>24</sup> [Nikula k. Finlandës](#), kërkesa nr. 28274/08, aktgjykim i 21 korrikut 2011, parag. 91.

<sup>25</sup> [Şahin Alpay k. Turqisë](#), kërkesa nr. 16538/17, aktgjykim i datës 20 mars 2018, parag. 182.

<sup>26</sup> *Po aty*.

<sup>27</sup> Komisioni i Venecias, [Opiniononi për nenet 216, 299, 301 dhe 314 të Kodit Penal të Turqisë](#), të miratuar më 11-12 mars 2016, parag. 68.



Sanksionet penale kanë një efekt më të madh frenues sesa (...) sanksionet civile. Kështu, pozita dominuese e institucioneve shtetërore kërkon që autoritetet të tregojnë përmbajtje në drejtim të procedurave penale. Efekti frenues mbi lirinë e shprehjes mund

**Pikat kryesore:**

- Shoqëria demokratike kërkon që disa forma të sjelljes të penalizohen. Megjithatë, përdorimi i ligjit penal për të kufizuar format e fjalës, dhe në veçanti, më pak të dëmshme për shoqërinë, nënkupton rreziqe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në veçanti, kjo përfshin heshtjen e zërave jopopullorë, kontravers, kritikë ose kundërshtues në shoqëri. Kjo do të shkonte kundër vlerës themelore të pluralizmit që është e natyrshme në të drejtën e lirisë së shprehjes dhe kundër parimeve të shoqërisë demokratike.
- Përmes jurisprudencës së saj, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka identifikuar rreziqe të shumta të shkaktuara nga përdorimi joproporcional i ligjit penal për të kufizuar lirinë e shprehjes, për individët e përfshirë në këto raste, por edhe për shoqërinë në tërësi.
- Duke pasur parasysh rolin kritik të medias, OJQ-ve dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut në shoqërinë demokratike, meqenëse ata i mbajnë përgjegjësi ata që janë në pushtet, Gjykata ka theksuar veçanërisht ndikimin e sanksioneve mbi të ashtuquajturit "mbikëqyrës publikë".
- Gjykata ka vendosur që edhe sanksionet e lehta financiare, vetëm 1 euro, ose vendosja

të lindë jo vetëm nga ndonjë sanksion, joproporcional apo jo, por edhe nga frika e sanksionit, madje edhe në rast të një lirimi përfundimtar, duke marrë parasysh mundësinë që një frikë e tillë ta dekurajojë dikë nga bërja e deklaratave të ngjashme në të ardhmen.<sup>28</sup>

### **III. Standardet e Përgjithshme të Këshillit të Evropës mbi përdorimin e ligjit penal për të sanksionuar lirinë e shprehjes: kufizim, qartësi dhe proporcionalitet**

Çdo kufizim që vendoset mbi lirinë e shprehjes, qoftë përmes ligjit penal, civil, administrativ apo tjetër, duhet të përmbushë të ashtuquajturin "test tre-pjesësh":

- (1) kufizimet duhet të jenë "të përcaktuara me ligj";
- (2) kufizimet duhet të synojnë një qëllim legjitim;
- (3) kufizimet duhet të jenë "të nevojshme në një shoqëri demokratike" në synim të atij qëllimi legjitim.

Ky test duhet të zbatohet në mënyrë strikte në lidhje me çdo kufizim:

Liria e shprehjes, siç përcaktohet në Nenin 10, i nënshtrohet një numri përjashtimesh të cilat, megjithatë, duhet të interpretohen ngushtë dhe domosdoshmëria për çdo kufizim duhet të përcaktohet bindshëm.<sup>29</sup>

<sup>28</sup> [Rekomandimi CM/Rec\(2016\)4 mbi mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias](#), i miratuar më 13 prill 2016, parag. 34.

<sup>29</sup> [Observer dhe Guardian k. Mbretërisë së Bashkuar](#), kërkesa nr. 13585/88, aktgjykim i 26 nëntorit 1991, parag. 59.

Që të jetë efektiv, ky test duhet të zbatohet në çdo fazë: nga ligjvënësit kur propozohet ose debatohet legjislacioni në parlament; nga zyrtarët publikë si zyrtarët e policisë ose rregullatorët e medias kur ata zbatojnë një kufizim rregullator në praktikë dhe nga gjykatat kur ato thirren për të vendosur një rast që përfshin kufizime të vendosura mbi të drejtën e lirisë së shprehjes.<sup>30</sup>

Për të zbutur rreziqet që lidhen me përdorimin e sanksioneve penale kundër ushtrimit të së drejtës së lirisë së shprehjes, Gjykata ka përpunuar kërkesat e mëposhtme, të rrënjosura në "testin e përgjithshëm tre-pjesësh" të përmendur më sipër (por që nuk duhet të ngatërrohet me të):

1. Shtetet duhet të ushtrojnë përmbajtje në përdorimin e ligjit penal;
2. Çdo ligj penal që kufizon lirinë e shprehjes duhet të hartohet me gjuhë të qartë dhe të padykuptimshme;
3. Përdorimi i ligjeve penale nuk duhet të kufizojë në mënyrë disproporcionale ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes.

Mosrespektimi i ndonjëres prej këtyre kërkesave do të thotë që ligji në fjalë, ose përdorimi i tij në një rast të veçantë, mund të shkelë të drejtën e lirisë së shprehjes, siç mbrohet nga Neni 10 i Konventës.

## **i. Kufizimi**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka përsëritur shpesh deklaratën e mëposhtme:

[P]ozicioni dominues që zë Qeveria e bën të domosdoshme që ajo të tregojë përmbajtje në drejtimin e procedurave penale, veçanërisht kur ka mjete të tjera në dispozicion për t'iu përgjigjur sulmeve dhe kritikave të pajustificuara të kundërshtarëve të saj ose të medias.<sup>31</sup>

Kjo deklaratë u bë për herë të parë në rastin [Castells k. Spanjës](#), e cila kishte të bënte me fillimin e procedurave penale për shpifje dhe një dënim me burgim pasues për një anëtar të Senatit spanjoll i cili kishte kritikuar politikën e qeverisë. Kjo i ka rrënjët në pjesën e "domosdoshmërisë" të testit me tre pjesë dhe që atëherë është përsëritur në shumë raste të tjera.

Për më tepër, Gjykata ka theksuar se masat penale duhet të përdoren vetëm kur shtetet veprojnë "në cilësinë e tyre si garantues të rendit publik".<sup>32</sup> Ngjashëm e rrënjosur në pjesën e "domosdoshmërisë", kjo buron nga një nga bazat kryesore teorike të përdorimit të së drejtës penale në shoqëri: ajo duhet të përdoret vetëm për të mbrojtur rendin publik dhe për të mbrojtur shoqërinë nga sjelljet dhe format e sjelljes veçanërisht të dëmshme. Kur alternativa të arsyeshme dhe më pak kufizuese janë të disponueshme sipas ligjit civil ose administrativ, shteti anëtar duhet t'i japë përparësi përdorimit të këtyre masave.<sup>33</sup>

---

<sup>30</sup> Si çështje e së drejtës ndërkombëtare publike, detyrimet e vendosura mbi shtetet anëtare nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut zbatohen për të gjitha organet shtetërore. Për shembull, siç do të elaborohet më poshtë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka qenë kritike ndaj legjislacionit që mundëson vendosjen e kufizimeve mbi lirinë e shprehjes kur ky nuk është hartuar në një gjuhë të qartë dhe të padykuptimshme.

<sup>31</sup> [Castells k. Spanjës](#), kërkesa nr. 11798/85, aktgjykimi i 23 prill 1992, parag. 46.

<sup>32</sup> *Po aty*.

<sup>33</sup> [Amorim Giestas dhe Jesus Costa Bordalo k. Portugalisë](#), kërkesa nr. 37840/10, aktgjykimi i datës 3 prill 2014, parag. 36; [Cumpănă dhe Mazăre k. Rumanisë](#), kërkesa nr. 33348/96, aktgjykimi i 17 dhjetorit 2004, parag. 113-115.

[D]uke pasur parasysh efektin frenues që legjislacioni që penalizon lloje të caktuara të shprehjes ka mbi lirinë e shprehjes dhe debatin publik, shtetet duhet të ushtrojnë përmbajtje në zbatimin e një legjislacioni të tillë, aty ku ai ekziston. Shtetet duhet të udhëhiqen në këtë drejtim nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut që konstaton se shqiptimi i dënimit me burg për një vepër të shtypit është i lejueshëm vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, veçanërisht kur të drejtat e tjera themelore janë cenuar rëndë, për shembull, në rastin e gjuhës së urrejtjes ose nxitjes së dhunës.<sup>34</sup>

## ii. Gjuhë e qartë dhe e padykuptimshme

Pjesa “e përcaktuar me ligj” e testit me tre pjesë kërkon që kufizimet mbi të drejtën e lirisë së shprehjes duhet të hartohen në një gjuhë të qartë dhe të padykuptimshme.

Norma nuk mund të konsiderohet "ligj" nëse nuk është formuluar me saktësi të mjaftueshme për t'i mundësuar qytetarit të rregullojë sjelljen e tij: ai duhet të jetë në gjendje - nëse është e nevojshme, me këshilla të përshtatshme - të parashikojë, në një shkallë të arsyeshme në rrethana, pasojat që një veprim i caktuar mund të sjellë.<sup>35</sup>

Gjykata ka pranuar se është e pamundur të formulohet ligji me saktësi të mprehtë dhe siguri absolute, dhe se në një farë mase, ligjet do të formulohen në gjuhë të përgjithshme.<sup>36</sup> Gjykata ka pranuar gjithashtu se ligjet nganjëherë mund të jenë të vështira për t'u interpretuar dhe se mund të jetë e nevojshme të merret këshilla ligjore për të vlerësuar pasojat e një veprimi të caktuar. Kjo është veçanërisht e vërtetë për anëtarët e medias, të cilët, për shkak të formimit të tyre profesional, pritet të veprojnë me njëfarë kujdesi.<sup>37</sup>

Megjithatë, për shkak të pasojave të rënda që mund të rrjedhin nga përdorimi i ligjit penal, Gjykata u ka kërkuar shteteve të sigurojnë që fushëveprimi i çdo vepre penale të përcaktohet me qartësi dhe saktësi. Për shembull, në rastin [Savva Terentyev k. Rusisë](#), Gjykata vendosi që kjo është kërkesë për të shmangur një përdorim të gjerë dhe potencialisht të ndikuar politikisht të diskrecionit të prokurorisë, i cili do të rezultonte në zbatim selektiv dhe potencialisht diskriminues të ligjit penal.<sup>38</sup> Rasti [Karastelev dhe të tjerë k. Rusisë](#) ofron një shembull tjetër të diskrecionit të gjerë në mënyrë disproporcionale të prokurorisë: Gjykata vendosi që fuqia e gjerë e prokurorëve për të lëshuar paralajmërime dhe urdhra sipas ligjit kundër ekstremizmit nuk përmbushi kërkesën e Nenit 10 të parashikueshmërisë.<sup>39</sup>

Në rastin [Semir Güzel k. Turqisë](#), Gjykata vendosi që legjislacioni që krijonte një ndalim të përgjithshëm për përdorimin nga partitë politike të çdo gjuhe tjetër përveç turqishtes dhe që përfshinte një kërkesë për të mos “qëndruar indiferentë ndaj veprimeve dhe akteve të tilla kur kryhen nga të tjerë” nuk përmbushte kërkesën e parashikueshmërisë: “Gjykata konstaton [ligjin] të jetë shumë larg të qenit i saktë në lidhje me llojin e mosveprimit që mund të formojë bazë për ndjekje penale dhe ndaj kujt do të zbatohej”.<sup>40</sup>

<sup>34</sup> [Rekomandimi CM/Rec\(2016\)4 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurisë së gazetarëve dhe të aktorëve të tjerë të mediave](#), i miratuar më 13 prill 2016.

<sup>35</sup> [Sunday Times k. Mbretërisë së Bashkuar](#), kërkesa nr. 6538/74, aktgjykim i 26 prillit 1979, parag. 49.

<sup>36</sup> *Po aty.*; [Perinçek k. Zvicrës \[GC\]](#), kërkesa nr. 27510/08, aktgjykim i datës 15 tetor 2015, parag. 131; [Lindon, Otchakovsky-Laurens dhe July k. Francës \[GC\]](#), kërkesa nr. 21279/02, 36448/02, aktgjykim i 22 tetorit 2007, parag. 41.

<sup>37</sup> [Chauvy dhe të tjerë k. Francës](#), kërkesa nr. 64915/01, aktgjykim i 29 qershorit 2004, parag. 43-45.

<sup>38</sup> [Savva Terentyev k. Rusisë](#), kërkesa nr. 10692/09, aktgjykim i 28 gushtit 2018, parag. 85.

<sup>39</sup> [Karastelev dhe të tjerë k. Rusisë](#), kërkesa nr. 16435/10, aktgjykim i 6 tetorit 2020. Shih edhe rastin [Selahattin Demirtaş k. Turqisë \(nr. 2\) \[GC\]](#), kërkesa nr. 14305/17, aktgjykim i 22 dhjetorit 2020, parag. 280.

<sup>40</sup> [Semir Güzel k. Turqisë](#), kërkesa nr. 29483/09, aktgjykim i datës 13 shtatori 2016, parag. 35-39.

Në një rast që kishte të bënte me një zyrtar gjyqësor i cili ishte zhvendosur për shkak të sanksionit disiplinor, Gjykata ka paralajmëruar se disa terma mund të jenë të hapura për interpretime të ndryshme dhe potencialisht mund të mos përmbushin kërkesën e parashikueshmërisë: “terma... të tilla si “dinjiteti” dhe “nderi i profesionit”, si dhe “dinjiteti dhe vlerësimi personal” janë të përgjithshme dhe lejojnë interpretime të shumëfishta.”<sup>41</sup>

### **iii. Proporcionaliteti: ligji penal duhet të përdoret në mënyrë të përshtatshme dhe pa teprime**

Kërkesa e tretë e paraqitur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në lidhje me përdorimin e ligjit penal për të sanksionuar shprehjen është e rrënjësor në pjesën e dytë dhe të tretë të testit me tre pjesë: kufizimet e ligjit penal duhet të përdoren në mënyrë të përshtatshme dhe pa teprime në synimin e një qëllimi legjitim.<sup>42</sup>

Gjykata e ka bërë të qartë se shteteve u lejohej të përdorin ligjin penal për të vendosur sanksione ndaj disa formave të shprehjes. Megjithatë, kur e bëjnë këtë, shtetet duhet të veprojnë “në mënyrë të përshtatshme dhe pa teprime”.<sup>43</sup>

Duke marrë në konsideratë kriterin e “pa tejkalim”, Gjykata i kushton vëmendje të veçantë ashpërsisë së një dënimi penal. Ajo ka deklaruar vazhdimisht se dënimi me burg për vepra penale të kryera nëpërmjet ushtrimit të lirisë së shprehjes (ndonjëherë të referuara shkurt si “vepra penale të shtypit”, që datojnë që nga një epokë para mediave sociale kur shtypi sundonte dhe gazetarët ishin të vetmit që mund të arrinin audienca të mëdha) është i lejueshëm vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.<sup>44</sup> Kur bëhet fjalë për lirinë e shprehjes në internet, Gjykata ka përsëritur se dënimi penal mund të ketë efekte frenuese për përdoruesit e rrjeteve sociale ose forumeve të diskutimit<sup>45</sup>. Në veçanti, atribumi i përgjegjësisë penale për komentet e palëve të treta mund të ketë pasoja negative për zonën e komenteve të një portali online dhe mund të ketë një efekt frenues mbi lirinë e shprehjes në internet<sup>46</sup>.

Gjykata konsideron se vendosja e dënimit me burg për një vepër penale në shtyp do të jetë në përputhje me lirinë e shprehjes së gazetarëve, siç garantohet nga Neni 10 i Konventës, vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, veçanërisht kur të drejtat e tjera themelore janë cenuar rëndë, si për shembull, në rastin e gjuhës së urrejtjes ose nxitjes së dhunës.<sup>47</sup>

<sup>41</sup> [Eminağaoğlu k. Turqisë](#), kërkesa nr. 76521/12, aktgjykimi i datës 9 mars 2021.

<sup>42</sup> Qëllime legjitime për kufizimin e lirisë së shprehjes sipas Nenit 10, parag. 2, të Konventës:

- Mbrojtja e sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike
- Parandalimi i çrregullimit ose krimit
- Mbrojtja e shëndetit apo moraleve
- Mbrojtja e reputacionit ose të drejtave të të tjerëve
- Parandalimi i zbulimit të informacionit të marrë në konfidencë
- Ruajtja e autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit.

<sup>43</sup> [Castells k. Spanjës](#), kërkesa nr. 11798/85, aktgjykimi i datës 23 prill 1992, parag. 46; shih edhe [Incal k. Turqisë](#), kërkesa nr. 22678/93, aktgjykimi i datës 9 qershor 1998, parag. 54.

<sup>44</sup> Për shembull, [Cumpănă dhe Mazăre k. Rumanisë](#), kërkesa nr. 33348/96, aktgjykimi i datës 17 dhjetor 2004 parag. 115; [Ruokanen dhe të tjerët k. Finlandës](#), kërkesa nr. 45130/06, aktgjykimi i datës 6 prill 2010, parag. 50; [Balaskas k. Greqisë](#), kërkesa nr. 73087/17, aktgjykimi i datës 5 nëntor 2020, parag. 51; dhe [Sanchez k. Francës](#), kërkesa nr. 45581/15, aktgjykimi i datës 15 maj 2023, parag. 207.

<sup>45</sup> [Sanchez k. Francës](#), kërkesa nr. 45581/15, aktgjykimi i 15 majit 2023, parag. 206.

<sup>46</sup> *Po aty*, parag. 205.

<sup>47</sup> [Cumpănă dhe Mazăre k. Rumanisë](#), kërkesa nr. 33348/96, aktgjykimi i datës 17 dhjetor 2004, parag. 115; [Sanchez k. Francës](#), kërkesa nr. 45581/15, aktgjykimi i datës 15 maj 2023, parag. 207.

Në rastet kur Gjykata ka identifikuar abuzim me sanksionet e ligjit penal, dhe në veçanti me burgimin, ajo ka urdhëruar lirim të menjëhershëm të personave të përfshirë. Në rastin [Fatullayev k. Azerbajxhanit](#), Gjykata e përshkroi dënimin me 30 muaj burg të dhënë ndaj një gazetari si "jashtëzakonisht joproporcional me çdo qëllim legjitim të përmendur" dhe udhëzoi shtetin të "sigurojë lirim të menjëhershëm të aplikantit".<sup>48</sup>

Komiteti i Ministrave ka paralajmëruar për përdorimin joproporcional të ligjit penal në [Rekomandimin CM/Rec\(2016\)4 e Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare mbi mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias](#), duke deklaruar:

Keqpërdorimi, abuzimi ose kërcënimi me përdorim të llojeve të ndryshme të legjislacionit për të parandaluar kontributet në debatin publik, duke përfshirë shpifjen, antiterrorizmin,

#### **Pikat kryesore:**

- Çdo kufizim që vendoset mbi lirinë e shprehjes, qoftë përmes ligjit penal, civil, administrativ apo tjetër, duhet të përmbushë të ashtuquajturin "test tre-pjesësh":
  - (1) kufizimet duhet të jenë "të përcaktuara me ligj";
  - (2) kufizimet duhet të synojnë një qëllim legjitim;
  - (3) kufizimet duhet të jenë "të nevojshme në një shoqëri demokratike" në synim të atij qëllimi legjitim.
- Për të zbutur rreziqet që lidhen me përdorimin e sanksioneve penale kundër ushtrimit të së drejtës së lirisë së shprehjes, Gjykata ka përpunuar kërkesat e mëposhtme, të rrënjësura në "testin e përgjithshëm tre-pjesësh" të përmendur më sipër (por që nuk duhet të ngatërrohet me të):
  1. Shtetet duhet të ushtrojnë përmbajtje në përdorimin e ligjit penal;
  2. Çdo ligj penal që kufizon lirinë e shprehjes duhet të hartohet me gjuhë të qartë dhe të padykuptimshme;
  3. përdorimi i ligjeve penale nuk duhet të kufizojë në mënyrë disproporcionale ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes.

Mosrespektimi i ndonjëres prej këtyre kërkesave do të thotë që ligji në fjalë, ose përdorimi i tij në një rast të veçantë, mund të shkelë të drejtën e lirisë së shprehjes, siç mbrohet nga Neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

sigurinë kombëtare, rendin publik, gjuhën e urrejtjes, blasfeminë dhe ligjet e kujtesës, mund të jenë efektive si mjete për frikësimin dhe heshtjen e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias që raportojnë për çështje me interes publik.<sup>49</sup>

#### **IV. Penalizimi i gjuhës së urrejtjes**

Ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut kërkon që format e rënda të gjuhës së urrejtjes të penalizohen. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike kërkon që shtetet të ndalojnë propagandën për luftë, si dhe avokimin e urrejtjes kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje

<sup>48</sup> [Fatullayev k. Azerbajxhanit](#), kërkesa nr. 40984/07, aktgjykimi i 22 prill 2010, parag. 130 dhe 177.

<sup>49</sup> [Rekomandimi CM/Rec\(2016\)4 mbi mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias](#), i miratuar më 13 prill 2016.

për diskriminim, armiqësi ose dhunë.<sup>50</sup> Ngjashëm, Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor kërkon që Shtetet të penalizojnë “çdo përhapje të ideve të bazuara në superioritet ose urrejtje racore, nxitje për diskriminim racor, si dhe të gjitha aktet e dhunës ose nxitje për akte të tilla kundër çdo race ose grupi personash me ngjyrë ose origjinë etnike tjetër”.<sup>51</sup>

Në vitet e fundit, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar nevojën që shtetet të ndërmarrin veprime jo vetëm kundër formave raciste, nacionaliste, etnike ose formave të tjera të gjuhës së urrejtjes që historikisht janë përdorur për të minuar të drejtat e pakicave, por edhe të ndërmarrin veprime kundër gjuhës së urrejtjes që synon pakicat seksuale ose gjuhën e urrejtjes me bazë gjinore. Për shembull, në rastin [Beizaras dhe Levickas k. Lituanië](#), që kishte të bënte me kërcënimet homofobike në internet, Gjykata theksoi se Shtetet duhet t'i përgjigjen gjuhës së urrejtjes bazuar në çdo qëndrim diskriminues.<sup>52</sup>

Nevoja për të luftuar gjuhën e urrejtjes me bazë gjinore theksohet në Konventën e Stambollit për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave, e cila thotë:

Palët ndërmarrin masa të nevojshme legjislative ose të tjera për të siguruar se çdo formë e sjelljes së padëshiruar verbale, joverbale ose fizike e natyrës seksuale me qëllim ose efekt të cenimit të dinjitetit të një personi, në veçanti kur krijohet një mjedis frikësues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, është subjekt i sanksioneve penale ose të tjera ligjore.<sup>53</sup>

Për të gjitha rastet e gjuhës së urrejtjes, Gjykata ka theksuar se “kur aktet që përbëjnë vepra të rënda penale drejtohen kundër integritetit fizik ose mendor të një personi, vetëm mekanizmat efikas të së drejtës penale mund të sigurojnë mbrojtje të përshtatshme dhe të shërbejnë si faktor pengues”. Gjykata theksoi se masat e ligjit penal janë “të nevojshme në lidhje me sulmet e drejtpërdrejta verbale dhe kërcënimet fizike të motivuara nga qëndrimi diskriminues” (theksi i shtuar).<sup>54</sup> Nevoja që shtetet të veprojnë rrjedh nga nenet 8 dhe 14 të Konventës, të cilat, të marra së bashku, japin të drejtën për të gëzuar respekt për jetën private të dikujt pa diskriminim. Në rastin [Oganezova k. Armenisë](#), Gjykata konstatoi se një fushatë homofobike e vazhdueshme dhe agresive kundër aplikantit, e cila përfshinte gjuhë urrejtjeje, u rrit në një nivel të tillë ashpërsie sa që përbënte trajtim çnjerëzor ose degradues dhe nxiti nenin 3 të Konventës.<sup>55</sup> Gjykata përsëriti se sulmet ndaj personave të kryera duke fyer, tallur ose shpifur grupe të caktuara të popullsisë përbëjnë gjuhë urrejtjeje dhe duhet të luftohen, përfshirë përdorimin e ligjit penal: “thirrjet e pamaskuara për dhunë [kërkojnë] mbrojtje nga ligji penal”.<sup>56</sup>

Mund të jetë e vështirë për autoritetet shtetërore të dinë se ku të vendosin vijën ndarëse. Në rastin [Beizaras dhe Levickas k. Lituanië](#), Gjykata vendosi që çdo një nga deklaratat e mëposhtme, të cilat ishin postuar si komente në Facebook, duhej të ishin “marrë seriozisht” nga autoritetet:

---

<sup>50</sup> Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, i miratuar me rezolutën 2200A (XXI) i Asamblesë së Përgjithshme, 16 dhjetor 1966, Neni 20, dhe i ratifikuar nga të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.

<sup>51</sup> Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, e miratuar me rezolutën 2106 (XX) të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, më 21 dhjetor 1965, dhe e ratifikuar nga të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.

<sup>52</sup> [Beizaras dhe Levickas k. Lituanië](#), kërkesa nr. 41288/15, aktgjykimi i 14 janarit 2020.

<sup>53</sup> [Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje](#), 11 maj 2011, CETS nr. 210, neni 40.

<sup>54</sup> [Beizaras dhe Levickas k. Lituanië](#), kërkesa nr. 41288/15, aktgjykimi i 14 janarit 2020, parag. 106-116.

<sup>55</sup> [Oganezova k. Armenisë](#), kërkesa nr. 71367/12 dhe 72961/12, aktgjykimi i datës 17 maj 2022.

<sup>56</sup> *Po aty*, parag. 120.





Gjykata theksoi se komentet ishin bërë virale dhe kishin arritur një audiencë të gjerë, dhe se çështja kishte të bënte me "thirrje të hapura për sulme ndaj integritetit fizik dhe mendor të aplikantëve ... të cilët kërkojnë mbrojtje me ligj penal".<sup>57</sup>

Megjithatë, jo të gjitha format e gjuhës së urrejtjes janë aq serioze sa kjo. Në fakt, mund të argumentohet se në shoqërinë moderne evropiane ekziston një sasi mjerisht e madhe e gjuhës së urrejtjes "të nivelit të ulët" e cila në mënyrë kumulative i shkakton dëm të madh strukturës së shoqërisë, por e cila, e marrë individualisht, nuk arrin nivelin e seriozitetit që do të justifikonte një sanksion penal.<sup>58</sup> Shtetet duhet të përdorin sanksione të së drejtës penale për të luftuar format serioze të gjuhës së urrejtjes, por ato duhet të përdorin metoda të tjera për të luftuar format më pak të rënda të gjuhës së urrejtjes; e rëndësishme është që ato duhet të trajtojnë edhe shkaqet rrënjësore të gjuhës së urrejtjes.

Luftimi i gjuhës së urrejtjes nuk duhet parë si diçka në kundërshtim me promovimin e të drejtës së lirisë së shprehjes. Raportuesi Special i OKB-së për Lirinë e Shprehjes ka theksuar se:

liria e shprehjes, të drejtat për barazi dhe jetë, dhe detyrimi i mosdiskriminimit përforcojnë njëra-tjetrën; ligji i të drejtave të njeriut u lejon shteteve dhe kompanive të përqendrohen në mbrojtjen dhe promovimin e fjalës së të gjithëve, veçanërisht atyre, të drejtat e të cilëve shpesh janë në rrezik, ndërkohë që adresojnë edhe diskriminimin publik dhe privat që minon gëzimin e të gjitha të drejtave.<sup>59</sup>

Duhet të theksohet se konteksti është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Shtetet duhet të veprojnë kundër diskursit të urrejtjes të drejtuar kundër komuniteteve historikisht të shtypura ose të marginalizuara, por në të njëjtën kohë duhet të bëhen lëshime kur bëhet fjalë për gjuhën politike, veçanërisht kur ushtrohet nga politikanët në debate të nxehta politike. Ligjet kundër gjuhës së urrejtjes (ose, siç do të diskutohet në seksionin tjetër, ligjet kundër shpifjes) nuk duhet të përdoren kurrë për të shtypur opozitën ose zëra të tjerë kritikë ndaj atyre që janë në pozita pushteti. Aktgjykimet e Gjykatës në rastin [Beizaras dhe Levickas k. Lituanisë](#) dhe [Oganezova k. Armenisë](#) janë shembuj të qartë të dështimit të autoriteteve për të vepruar në mbrojtje të komuniteteve të marginalizuara. Këto aktgjykime mund të krahasohen me aktgjykimet e Gjykatës në raste të tilla si [Stomakhin k. Rusisë](#), të cilat kishin të bënin me dënimin e aplikantit për gjuhë urrejtjeje për artikujt që ai kishte shkruar mbi konfliktin e armatosur në Çeçeni. Në këtë rast, Gjykata kritikoi autoritetet për dështimin në balancimin e lirisë së shprehjes me nevojën për

<sup>57</sup> [Beizaras dhe Levickas k. Lituanisë](#), kërkesa nr. 41288/15, aktgjykimi i 14 janarit 2020, paragrafi 128.

<sup>58</sup> Siç është raportuar, ndër të tjera, nga Raportuesi Special i OKB-së për Lirinë e Shprehjes, [Raporti i Raportuesit Special mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës së lirisë së mendimit dhe shprehjes: Gjuhë urrejtjeje](#), Dok. Nr. A/74/486, 9 tetor 2019.

<sup>59</sup> Po aty, paragrafi 4.

t'u mbrojtur nga gjuha e urrejtjes dhe theksoi nevojën që shtetet të tregojnë kujdes se kur dhe si t'i përdorin ligjet kundër gjuhës së urrejtjes.<sup>60</sup> Ngjashëm, në rastin [Tagiyev dhe Huseynov k. Azerbajxhanit](#), që kishte të bënte me një dënim për gjuhë urrejtjeje fetare në lidhje me një artikull që krahasonte vlerat perëndimore dhe lindore, Gjykata kritikoi autoritetet për dështimin në balancimin e të drejtës së aplikantëve për t'i përcjellë publikut pikëpamjet e tyre mbi fenë kundrejt të drejtës së njerëzve fetarë për respektimin e bindjeve të tyre.<sup>61</sup> Në rastin [Fatullayev k. Azerbajxhanit](#), Gjykata kritikoi përdorimin me sa duket të motivuar politikisht të ligjeve kundër gjuhës së urrejtjes për të burgosur një kritik të njohur të qeverisë:

Vetë fakti që ai diskutoi situatën sociale dhe ekonomike në rajonet e populluara nga një pakicë etnike dhe shprehu një mendim në lidhje me tensionet e mundshme politike në ato rajone nuk mund të konsiderohet si nxitje për armiqësi etnike. Edhe pse pasazhet përkatëse mund të kenë përmbajtur disa opinione kategorike dhe të ashpra dhe një shkallë të caktuar ekzagjerimi (...), ato nuk përmbanin gjuhë urrejtjeje dhe nuk mund të thuhet se inkurajojnë dhunën ndëretnike ose se denigrojnë ndonjë grup etnik në asnjë mënyrë.<sup>62</sup>

[Ë]shtë shumë e rëndësishme që autoritetet vendase të ndjekin një qasje të kujdesshme në përcaktimin e fushëveprimit të krimeve të gjuhës së urrejtjes dhe interpretimi i rreptë i dispozitave ligjore përkatëse për të shmangur ndërhyrjet e tepruara nën maskën e veprimeve të ndërmarra kundër "gjuhës së urrejtjes", ku akuza të tilla ngrihen për një kritikë të thjeshtë të qeverisë, institucioneve të shteteve anëtare dhe politikave dhe praktikave të tyre.<sup>63</sup>

Është gjithashtu e rëndësishme që mediat të kenë lirinë për të raportuar mbi urrejtjen dhe intolerancën dhe për të zgjedhur teknikën, stilet dhe mjetet e raportimit, me kusht që ato të përpiqen t'i ofrojnë publikut informacion të saktë dhe të besueshëm.<sup>64</sup> Kjo mund të përfshijë intervista me individë për të ekspozuar, analizuar dhe shpjeguar qëndrime diskriminuese ose të urrejtjes; gazetarët nuk duhet të mbahen përgjegjës për raportimin e pikëpamjeve të tilla për sa kohë që gazetarët ose media përkatëse nuk promovojnë vetë urrejtje.<sup>65</sup> Gjykata ka vendosur:

"Ndëshkimi i një gazetari për ndihmën në përhapjen e deklaratave të bëra nga një person tjetër në një intervistë mund të dëmtojë seriozisht kontributin e shtypit në diskutimin e çështjeve me interes publik dhe nuk duhet të parashikohet përveçse nëse ka arsye veçanërisht të forta për ta bërë këtë".<sup>66</sup>

Duke u bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, Këshilli i Evropës ka zhvilluar më tej standarde që ofrojnë udhëzime mbi masat që mund të merren për të luftuar gjuhën e urrejtjes, duke përfshirë hartimin e ligjeve dhe rregulloreve. Në vitin 2022, Komiteti i Ministrave nxori [Rekomandimin CM/Rec\(2022\)16 e Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare për luftimin e gjuhës së urrejtjes](#). Ky thekson se, për të parandaluar dhe luftuar në mënyrë efektive gjuhën e urrejtjes, "është thelbësore të identifikohen dhe të kuptohen shkaqet e saj rrënjësore dhe konteksti më i gjerë shoqëror, si dhe shprehjet e saj të ndryshme dhe ndikimet e ndryshme tek

<sup>60</sup> [Stomakhin k. Ruisë](#), kërkesa nr. 52273/07, aktgjykimi i datës 9 maj 2018.

<sup>61</sup> [Tagiyev dhe Huseynov k. Azerbajxhanit](#), kërkesa nr. 13274/08, aktgjykimi i 5 dhjetorit 2019.

<sup>62</sup> [Fatullayev k. Azerbajxhanit](#), kërkesa nr. 40984/07, aktgjykimi i 22 prillit 2010, paragrafi 126.

<sup>63</sup> [Stomakhin k. Ruisë](#), kërkesa nr. 52273/07, aktgjykimi i datës 9 maj 2018, paragrafi 117.

<sup>64</sup> [Rekomandimi CM/Rec\(2022\)16 i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare për luftimin e gjuhës së urrejtjes](#), miratuar më 20 maj 2022, paragrafi 38.

<sup>65</sup> [Jersild k. Danimarkës](#), kërkesa nr. 15890/89, aktgjykimi i datës 23 shtatori 1994.

<sup>66</sup> *Po aty*, paragrafi 35.



ata që janë në shënjestër”. Çdo masë e ndërmarrë duhet të jetë e synuar në mënyrë të kujdesshme dhe në proporcion me shkallën e ashpërsisë së shprehjes së saj. Format serioze të gjuhës së urrejtjes kërkojnë një reagim sipas ligjit penal, por manifestimet e tjera kërkojnë një reagim sipas ligjit civil ose administrativ ose duhet të trajtohen përmes edukimit dhe ndërgjegjësimit; kundër-gjuhës dhe kundërmasave të tjera; masave që nxisin dialogun dhe mirëkuptimin ndërkulturor, duke përfshirë edhe përmes mediave dhe mediave sociale; dhe aktiviteteve përkatëse edukative, të ndarjes së informacionit dhe të ndërgjegjësimit.

Komiteti i Ministrave ka identifikuar disa kategori të gjuhës së urrejtjes që kërkojnë një përgjigje penale:

- (1) nxitja publike për të kryer gjenocid, krime kundër njerëzimit ose krime lufte;
- (2) nxitje publike për urrejtje, dhunë ose diskriminim;
- (3) kërcënime raciste, ksenofobike, seksiste dhe LGBTI-fobike;
- (4) fyerje publike raciste, ksenofobike, seksiste dhe LGBTI-fobike sipas kushteve të tilla si ato të përcaktuara posaçërisht për fyerjet online në Protokollin Shtesë të Konventës për Krimin Kibernetik;<sup>67</sup>
- (5) banalizimi i mohimit publik dhe miratimi i gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit ose krimeve të luftës; dhe
- (6) shpërndarja ndërkombëtare e materialit që përmban shprehje të tilla të gjuhës së urrejtjes të listuara më sipër, duke përfshirë idetë e bazuara në epërsi racore ose urrejtje.

Përtej këtyre kategorive, Komiteti i Ministrave rekomandon që, kur të përcaktojnë nëse kërkohet një përgjigje sipas ligjit penal, shtetet duhet të marrin në konsideratë sa vijon:

- përmbajtjen e shprehjes;
- kontekstin politik dhe social në kohën e shprehjes;
- qëllimin e folësit;
- rolin dhe statusin e folësit në shoqëri;
- mënyrën se si shpërndahet apo përforcohet shprehja;
- aftësinë e shprehjes për të çuar në pasoja të dëmshme, duke përfshirë afërsinë e pasojave të tilla;

---

<sup>67</sup> [Protokolli Shtesë i Konventës për Krimin Kibernetik në lidhje me penalizimin e akteve me natyrë raciste dhe ksenofobike të kryera përmes sistemeve kompjuterike](#), 28 janar 2003, ETS nr. 189, nenet 3-6 mbi përhapjen e materialeve raciste dhe ksenofobike; kërcënimet me motive raciste dhe ksenofobike; fyerjet me motive raciste dhe ksenofobike; dhe mohimin, minimizimin e rëndë, miratimin ose justifikimin e gjenocidit ose krimeve kundër njerëzimit.

- natyrën dhe madhësinë e audiencës, si dhe karakteristikat e grupit të synuar.<sup>68</sup>

#### **Pikat kryesore:**

- Ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut kërkon që format e rënda të gjuhës së urrejtjes të kriminalizohen (për shembull, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike kërkon që shtetet të ndalojnë propagandën për luftë, si dhe avokimin e urrejtjes kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë).
- Duhet të theksohet se Karta konteksti është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Shtetet duhet të veprojnë kundër diskursit të urrejtjes të drejtuar kundër komuniteteve historikisht të shtypura ose të marginalizuara, por në të njëjtën kohë duhet të bëhen lëshime kur bëhet fjalë për gjuhën politike.
- Duke u bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, Këshilli i Evropës ka zhvilluar më tej standarde që ofrojnë udhëzime mbi masat që mund të merren për të luftuar gjuhën e urrejtjes, duke përfshirë hartimin e ligjeve dhe rregulloreve. Në vitin 2022, Komiteti i Ministrave nxori [Rekomandimin CM/Rec\(2022\)16 për luftimin e gjuhës së urrejtjes](#). Ky thekson se, për të parandaluar dhe luftuar në mënyrë efektive gjuhën e urrejtjes, “është thelbësore të identifikohen dhe të kuptohen shkaqet e saj rrënjësore dhe konteksti më i gjerë shoqëror, si dhe shprehjet e saj të ndryshme dhe ndikimet e ndryshme tek ata që janë në shënjestër”.
- Çdo masë e ndërmarrë duhet të jetë e synuar në mënyrë të kujdesshme dhe në proporcion me shkallën e ashpërsisë së shprehjes së saj. Format serioze të gjuhës së urrejtjes kërkojnë një reagim sipas ligjit penal, por manifestimet e tjera kërkojnë një reagim sipas ligjit civil ose administrativ ose duhet të trajtohen përmes edukimit dhe ndërgjegjësimit: kundër-gjuhës dhe kundërmasave të tiera: masave që nxisin dialogun

## **V. Penalizimi i shpifjes dhe fyerjes**

Penalizimi i ligjeve për shpifje dhe fyerje është një temë e përsëritur në diskursin ndërkombëtar mbi lirinë e shprehjes. Ligjet për shpifjen përdoren shpesh nga ata që janë në pozita pushteti dhe që dëshirojnë t'i heshtin kritikët e tyre.<sup>69</sup> Historikisht, ligjet penale për shpifjen dhe fyerjen u prezantuan si një alternativë ndaj përballjes; dhe parë në një perspektivë historike, është sigurisht e preferueshme që mosmarrëveshjet që përfshijnë sulme të dyshuara ndaj reputacionit të dikujt të zgjidhen përmes përdorimit të ligjit penal sesa me shpata ose pistoletë. Megjithatë, në shoqërinë moderne, ligjet civile për shpifjen ofrojnë një alternativë më pak kufizuese ndaj përdorimit të ligjeve penale për shpifjen në të gjitha rastet përveç atyre më serioze. Shpifja mund të trajtohet edhe përmes mekanizmave alternativë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, siç janë organet vetërregulluese të medias.

Ndërsa Neni 8 i Konventës u imponon shteteve një detyrim për të ndërmarrë hapa legjislativë për t'u mbrojtur nga sulmet serioze ndaj reputacionit,<sup>70</sup> ai kërkon që të përdoret masa më pak

<sup>68</sup> [Rekomandimi CM/Rec\(2022\)16 i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare për luftimin e gjuhës së urrejtjes](#), i miratuar më 20 maj 2022.

<sup>69</sup> Shumica e lëndëve të lirisë së shprehjes të shqyrtuara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut kanë të bëjnë me shpifjen.

<sup>70</sup>P.sh. rasti [A. K. Norvegjisë](#), kërkesa nr. 28070/06, aktgjykim i 9 prillit 2009.

kufizuese në dispozicion. Gjykata nuk e ka përjashtuar përdorimin e ligjit penal për shpifjen,<sup>71</sup> por duke pasur parasysh kërkesën e përgjithshme që shtetet duhet të tregojnë përmbajtje në përdorimin e procedurave penale,<sup>72</sup> ajo ka rekomanduar që shtetet duhet të përdorin lloje të tjera masash, të tilla si mjete juridike civile dhe disiplinore. Në veçanti, “vlerësimi i proporcionalitetit të një ndërhyrjeje në të drejtat e mbrojtura në shumë raste do të varet nga fakti nëse autoritetet mund të kishin përdorur mjete të tjera përveç një dënimi penal, siç janë mjetet juridike civile dhe disiplinore”.<sup>73</sup>

[D]ënimi i aplikantëve për gjoba penale, i shoqëruar me dëmshpërblim, ishte qartësisht joproporcional, veçanërisht pasi ... Kodi Civil parashikon një mjet juridik specifik për mbrojtjen e nderit dhe reputacionit.<sup>74</sup>

Kur përdoret ligji penal në përgjigje të rasteve të shpifjes, kjo nuk duhet të rezultojë kurrë në burgim.<sup>75</sup> Në rastin [Cumpăna dhe Mazăre k. Rumanisë](#), që kishte të bënte me dënimin me shtatë muaj burg për shpifje të gazetarëve që kishin shkruar një artikull duke akuzuar zyrtarët publikë për korrupsion, Gjykata theksoi se burgimi nuk është kurrë një dënim i përshtatshëm.<sup>76</sup> Në rastet kur Gjykata ka mbështetur dënimet penale për shpifje, ajo ka theksuar se sanksionet ishin modeste dhe proporcionale. Për shembull, në rastin [Tammer k. Estonisë](#), Gjykata vuri në dukje posaçërisht "shumën e kufizuar të gjobës së vendosur" në mbështetjen e dënimit (gjoba në fjalë ishte 10 herë më e lartë se paga minimale ditore).<sup>77</sup>

Megjithatë, Gjykata ka theksuar gjithashtu se edhe një gjobë minimale prej 1 eurosh është prapëseprapë një gjobë, dhe një dënim penal ka pasoja të rënda për individin në fjalë. Edhe shqiptimi i një dënimi me kusht mund të ketë një ndikim serioz në ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes.<sup>78</sup> Në rastin [De Carolis dhe France Télévisions k. Francës](#), që kishte të bënte me dënimin e një kompanie televizive për shpifje për një raport që kishte implikuar një princ saudit në sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001, Gjykata theksoi se pavarësisht gjobës minimale të vendosur, dënimi ishte ende një çështje serioze:

“[E]dhe kur sanksioni është më i moderuari i mundshëm, siç është një dënim i shoqëruar me një përjashtim nga dënimi në nivel penal dhe kërkesën për të paguar vetëm një “euro simbolike” për dëmshpërblim, kjo megjithatë përbën një sanksion penal. Një sanksion

<sup>71</sup> Ajo ka deklaruar se “[në] dritën e hapësirës së vlerësimit që u është lënë Shteteve Kontraktuese nga Neni 10 i Konventës, një masë penale si përgjigje ndaj shpifjes nuk mund të konsiderohet, si e tillë, joproporcionale me qëllimin e synuar.” [Radio France dhe të tjerë k. Francës](#), kërkesa nr. 53984/00, aktgjykim i datës 30 mars 2004, paragrafi 40; [Lindon, Otchakovsky-Laurens dhe July k. Francës](#) [GC], kërkesa nr. 21279/02, 36448/02, aktgjykim i 22 tetorit 2007, paragrafi 59.

<sup>72</sup> Referuar më sipër. Shih edhe rastin [Morice k. Francës](#) [Gjykata e Përgjithshme], kërkesa nr. 29369/10, aktgjykim i datës 23 prill 2015, paragrafi 176; [De Carolis dhe France Télévisions k. Francës](#), kërkesa nr. 29313/10, aktgjykim i datës 21 janar 2016, paragrafi 44; [Otegi Mondragon k. Spanjës](#), kërkesa nr. 2034/07, aktgjykim i datës 15 mars 2011, paragrafi 58; [Incal k. Turqisë](#), kërkesa nr. 22678/93, aktgjykim i datës 9 qershor 1998, paragrafi 54; [Öztürk k. Turqisë](#) [GC], kërkesa nr. 22479/93, aktgjykim i datës 28 shtator 1999, paragrafi 66.

<sup>73</sup> [Raichinov k. Bullgarisë](#), kërkesa nr. 47579/99, aktgjykim i 20 prillit 2006, paragrafi 50. Shih edhe rastin [Ceylan k. Turqisë](#) [GC], kërkesa nr. 23556/94, aktgjykim i 8 korrikut 1999, paragrafi 34.

<sup>74</sup> [Amorim Giestas dhe Jesus Costa Bordalo k. Portugalisë](#), kërkesa nr. 37840/10, aktgjykim i datës 3 prill 2014, paragrafi 36. Shih edhe rastin [Veiga Cardoso k. Portugalisë](#), kërkesa nr. 48979/19, aktgjykim i datës 16 janar 2024, paragrafi 19; [Patrício Monteiro Telo de Abreu k. Portugalisë](#), kërkesa nr. 42713/15, aktgjykim i datës 7 qershor 2022, paragrafi 46.

<sup>75</sup> Në disa vende, ligjet kundër gjuhës së urrejtjes penalizojnë fyerjet ose vërejtjet shpifëse me motive raciste. Për aq sa kjo mund të shihet si pjesë e ligjit për shpifjen, këto do të ishin të vetmet raste të ligjit për shpifjen ku mund të shqiptohet dënim me burgim.

<sup>76</sup> [Cumpăna dhe Mazăre k. Rumanisë](#), kërkesa nr. 33348/96, aktgjykim i 17 dhjetorit 2004, paragrafi 115.

<sup>77</sup> [Tammer k. Estonisë](#), kërkesa nr. 41205/98, aktgjykim i 6 shkurtit 2001, paragrafi 69.

<sup>78</sup> Siç është diskutuar në Seksionin 2 të këtij Udhëzuesi.

më i ulët nuk mund të jetë i mjaftueshëm, në vetvete, për të justifikuar ndërhyrjen në të drejtën e shprehjes së aplikantit. Një sulm ndaj lirisë së shprehjes mund të ketë një efekt pengues në ushtrimin e kësaj lirie dhe kjo nuk zvogëlohet nga natyra relativisht e moderuar e gjobës; ajo që ka rëndësi është se aplikantët u dënuan”.<sup>79</sup>

Gjykata ka qenë shpesh kritike ndaj përdorimit joproporcional dhe të tepërt të ligjeve penale për shpifjen. Në rastin [Amorim Giestas dhe Jesus Costa Bordalo k. Portugalisë](#), që kishte të bënte me dënimin për shpifje të një gazetari dhe një redaktori gazete për një artikull në të cilin ata kishin shprehur dyshime se dhurimi i mobilieve nga një gjykatë lokale për një shoqatë komunale kishte sjellë përfitime për zyrtarët publikë, Gjykata vendosi se përdorimi i ligjit penal kishte qenë joproporcional, veçanërisht kur kodi civil parashikonte një mjet të përshtatshëm juridik.<sup>80</sup>

Gjykata ka qenë gjithashtu shumë kritike ndaj përdorimit të ligjeve penale për shpifjen për të heshtur zërat e pavarur ose politikë të opozitës në shoqëri. Në një nga aktgjykimet e para për shpifje, [Lingens k. Austrisë](#), Gjykata vendosi që një sanksion penal për shpifje “mund të pengojë shtypin në kryerjen e detyrës së tij si ofrues informacioni dhe mbikëqyrës publik”.<sup>81</sup> Në rastin [Castells k. Spanjës](#), që kishte të bënte me dënimin për shpifje të një politikani, Gjykata deklaroi se “roli i shquar i shtypit në një shtet të qeverisur nga sundimi i ligjit nuk duhet të harrohet” dhe vazhdoi duke deklaruar thënien e saj të përsëritur shpesh se, “pozicioni dominues që zë Qeveria e bën të domosdoshme që ajo të tregojë përmbajtje në përdorimin e procedurave penale, veçanërisht kur ka mjete të tjera në dispozicion për t’iu përgjigjur sulmeve dhe kritikave të pajustificuara të kundërshtarëve të saj ose të medias”.<sup>82</sup> Rasti [Otegi Mondragon k. Spanjës](#), kishte të bënte gjithashtu me dënimin për shpifje të një politikani.<sup>83</sup>

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka shprehur shqetësimin e saj të fortë në lidhje me abuzimin e mundshëm të ligjeve penale për shpifjen. Duke u bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Rezoluta e saj 1577(2007) përcakton që shtetet që mbajnë ligje penale për shpifjen në statutet e tyre duhet t’i zëvendësojnë këto ligje me ligje civile për shpifjen të hartuara në mënyrë të përshtatshme. Në pritje të këtij procesi të “depenalizimit”, Asambleja Parlamentare ka kërkuar që ligjet penale për shpifjen duhet, të paktën, të parashikojnë një mbrojtje të së vërtetës dhe një mbrojtje të interesit publik.

“Asambleja ... u kërkon shteteve anëtare t’i zbatojnë këto ligje me përmbajtjen më të madhe, pasi ato mund të shkelin seriozisht lirinë e shprehjes. Për këtë arsye, Asambleja këmbëngul që të ketë mbrojtje procedurale që i mundësojnë kujt do që akuzohet për shpifje të mbështesë deklaratat e tij në mënyrë që të lirohet nga përgjegjësia e mundshme penale. Përveç kësaj, deklaratat ose pretendimet që bëhen në interes të publikut, edhe nëse ato rezultojnë të pasakta, nuk duhet të jenë të dënueshme me kusht që ato të jenë bërë pa dijeninë e pasaktësisë së tyre, pa qëllim për të shkaktuar dëm, dhe vërtetësia e tyre të jetë kontrolluar me kujdesin e duhur”.<sup>84</sup>

<sup>79</sup> Kërkesa nr. 29313/10, 21 janar 2016, parag. 63; Shih edhe rastin [Morice k. Francës \[GC\]](#), kërkesa nr. 29369/10, aktgjykim i 23 prillit 2015, parag. 176.

<sup>80</sup> [Amorim Giestas dhe Jesus Costa Bordalo k. Portugalisë](#), kërkesa nr. 37840/10, aktgjykim i datës 3 prill 2014, parag. 36.

<sup>81</sup> [Lingens k. Austrisë](#), kërkesa nr. 9815/82, aktgjykim i 8 korrikut 1986, parag. 44.

<sup>82</sup> [Castells k. Spanjës](#), kërkesa nr. 11798/85, aktgjykim i datës 23 prill 1992, parag. 43 dhe 46; siç diskutohet edhe në Seksionin 3 të këtij Udhëzuesi.

<sup>83</sup> [Otegi Mondragon k. Spanjës](#), kërkesa nr. 2034/07, aktgjykim i datës 15 mars 2011, parag. 50.

<sup>84</sup> Asambleja Parlamentare, [Rezoluta 1577 \(2007\). Drejt depenalizimit të shpifjes](#), e miratuar më 4 tetor 2007.

Për më tepër, Asambleja Parlamentare ka deklaruar se “dënimet me burg për shpifje duhet të shfuqizohen pa vonesë të mëtejshme”; dhe u ka kërkuar atyre shteteve ku dënimet me burg janë ende të disponueshme në letër, por nuk janë të imponuara në praktikë, të reformojnë ligjet në fuqi “në mënyrë që të mos u japin asnjë justifikim, sado të pajustificuar, atyre vendeve që vazhdojnë t’i imponojnë ato, duke provokuar kështu një gërryerje të lirive themelore”.<sup>85</sup>

Mandatet Speciale për Lirinë e Shprehjes në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB), Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Organizatën e Shteteve Amerikane (OShA) dhe Unionin Afrikan (UA), kanë bërë thirrje të përsëritura për depenalizimin e ligjeve për shpifjen, duke vënë në dukje efektin e tyre të madh frenues dhe disproporcionalitetin e tyre për mbrojtjen e reputacionit.<sup>86</sup> Në Raportin e saj të vitit 2022 “Keqpërdorimi” i sistemit gjyqësor për të sulmuar lirinë e shprehjes”, UNESCO ka shprehur shqetësimin se:

“Dispozitat për shpifjen dhe fyerjen dhe zbatimi i tyre janë forcuar, duke përfshirë integrimin e tyre në legjislacionin e ri mbi sigurinë kibernetike, antiterrorizmin ose që synojnë luftimin e dezinformimit ose gjuhës së urrejtjes, të karakterizuara nga përkufizime të paqarta që lehtësojnë përdorimin e tyre abuziv. Kjo situatë ka mundësuar shtypjen e fjalës kundër zyrtarëve publikë”.<sup>87</sup>

---

<sup>85</sup> Po aty. Gjykata i është referuar Rezolutës 1577(2007) në disa raste, duke përfshirë rastin [Mariapori k. Finlandës](#), kërkesa nr. 37751/07, aktgjykimi i datës 6 korrik 2010, paragrafi 69; rastin [Niskasaari dhe të tjerët k. Finlandës](#), kërkesa nr. 37520/07, aktgjykimi i datës 6 korrik 2010, paragrafi 77; rastin [Saaristo dhe të tjerët k. Finlandës](#), kërkesa nr. 184/06, aktgjykimi i datës 12 tetor 2010, paragrafi 69; rastin [Długotłęcki k. Polonisë](#), kërkesa nr. 23806/03, aktgjykimi i datës 24 shkurt 2009, paragrafi 47; rastin [Ruokanen dhe të tjerët k. Finlandës](#), kërkesa nr. 45130/06, aktgjykimi i datës 6 prill 2010, paragrafi 50.

<sup>86</sup> Për shembull, në vitin 2021 [Deklaratë e Përbashkët mbi Politikanët dhe Zyrtarët Publikë dhe Lirinë e Shprehjes](#).

<sup>87</sup> UNESCO, “Keqpërdorimi” i sistemit gjyqësor për të sulmuar lirinë e shprehjes, CI-2022/WTR/4. 2022, fq. 11.

Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut u ka kërkuar gjithashtu shteteve të shfuqizojnë ose rishikojnë ligjet penale për shpifjen.<sup>88</sup>

**Pikat kryesore:**

- Ligjet për shpifjen përdoren shpesh nga ata që janë në pozita pushteti dhe që dëshirojnë t'i heshtin kritikët e tyre.
- Gjykata nuk e ka përjashtuar përdorimin e ligjit penal për shpifjen, por duke pasur parasysh kërkesën e përgjithshme që shtetet duhet të tregojnë përmbajtje në përdorimin e procedurave penale, ajo ka rekomanduar që shtetet duhet të përdorin lloje të tjera masash, të tilla si mjete juridike civile dhe disiplinore: “vlerësimi i proporcionalitetit të një ndërhyrjeje në të drejtat e mbrojtura në shumë raste do të varet nga fakti nëse autoritetet mund të kishin përdorur mjete të tjera përveç një dënimi penal, siç janë mjetet juridike civile dhe disiplinore”.
- Ligjet civile për shpifjen ofrojnë një alternativë më pak kufizuese ndaj përdorimit të ligjeve penale për shpifjen në të gjitha rastet përveç atyre më serioze. Shpifja mund të trajtohet edhe përmes mekanizmave alternativë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, siç janë organet vetërregulluese të medias.
- Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se, kur përdoret ligji penal në përgjigje të rasteve të shpifjes, kjo nuk duhet të rezultojë kurrë në burgim. Në rastin [Cumpana dhe Mazare k. Rumanisë](#), që kishte të bënte me dënimin me shtatë muaj burg për shpifje të gazetarëve që kishin shkruar një artikull duke akuzuar zyrtarët publikë për korrupsion, Gjykata theksoi se burgimi nuk është kurrë një dënim i përshtatshëm.
- Gjykata ka theksuar gjithashtu se edhe një gjobë minimale prej 1 eurosh është prapëseprapë një gjobë, dhe një dënim penal ka pasoja të rënda për individin në fjalë.

## **VI. Penalizimi i përhapjes së informacionit konfidencial**

Informacioni "konfidencial" mund të ketë të bëjë me informacionin që është privat në natyrë, informacionin me natyrë tregtare, informacionin që ka të bëjë me sekretet shtetërore ose informacionin që ka të bëjë me hetimet dhe procedurat në hetimet dhe procedurat gjyqësore. Ligji i të drejtave të njeriut mundëson penalizimin e "rrjedhjes" ose publikimit të këtyre llojeve të informacionit, në varësi të kërkesave të përgjithshme të përmbajtjes, qartësisë në ligj dhe proporcionalitetit të përcaktuara në Seksionin 3 të këtij Udhëzuesi.

Gjykata ka shqyrtuar disa raste që përfshijnë shpërndarjen e informacionit konfidencial nëpërmjet medias, qoftë në formën e materialit të “rrjedhur” te gazetarët ose nga gazetarë që përdorin dredhi dhe metoda të fshehta. Në secilën prej këtyre rasteve, Gjykata ka deklaruar se natyra e interesit publik të informacionit në fjalë është me rëndësi të madhe. Megjithatë, ky ekuilibër është i ndryshëm në varësi të faktit nëse informacioni është i një cilësie konfidenciale private, i mbuluar nga Neni 8, apo përbën sekret shtetëror ose informacion të një natyre të

<sup>88</sup> Për shembull, Këshilli i të Drejtave të Njeriut i OKB-së, [Rezolutë mbi sigurinë e gazetarëve](#), A/HRC/RES/51/9 (2022), e miratuar më 6 tetor 2022; Këshilli i të Drejtave të Njeriut i OKB-së, [Rezolutë mbi sigurinë e gazetarëve](#), A/HRC/RES/45/18 (2020), e miratuar më 6 tetor 2020.

ngjashme. Në rastin e kësaj të fundit, Gjykata ka theksuar natyrën e informacionit në interes të publikut:

“Liria e shtypit merr një rëndësi edhe më të madhe në rrethanat kur aktivitetet dhe vendimet shtetërore i shpëtojnë shqyrtimit demokratik ose gjyqësor për shkak të natyrës së tyre konfidenciale ose sekrete. Dënimi i një gazetari për zbulimin e informacionit që konsiderohet konfidencial ose sekret mund t’i dekurajojë ata që punojnë në media nga informimi i publikut mbi çështje me interes publik. Si rezultat, shtypi mund të mos jetë më në gjendje të luajë rolin e tij jetësor si “mbikëqyrës publik” dhe aftësia e shtypit për të ofruar informacion të saktë dhe të besueshëm mund të ndikohet negativisht”.<sup>89</sup>

Në rastin e parë, kur informacioni është i një natyre konfidenciale private, Gjykata ka theksuar se Shtetet kanë detyrimin të ndërmarrin hapa për të mbrojtur të drejtën e respektimit të jetës private dhe duhet ta balancojnë këtë me kërkesat e lirisë së shprehjes.

Gjykata ka theksuar gjithashtu se mënyra se si gazetarët kanë marrë informacionin, vërtetësia e atij informacioni dhe sjellja e gazetarëve - duke përfshirë nëse ata kanë shkelur apo jo ndonjë ligj në marrjen e informacionit - janë konsiderata relevante.<sup>90</sup> Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se asnjë nga këto konsiderata nuk është vendimtare në vetvete; përkundrazi, ato kontribuojnë në një pamje të përgjithshme të cilën gjykatat dhe autoritetet e tjera kombëtare duhet ta marrin parasysh.<sup>91</sup>

#### **i. Mbrojtja e sekretit të hetimeve penale**

Në rastin [Bédat k. Zvicrës](#), Gjykata shqyrtoi dënimin e një gazetari për një artikull në lidhje me procedurat penale kundër një shoferi i cili ka përplasur makinën e tij me një grup këmbësorësh, duke vrarë tre persona dhe duke plagosur tetë të tjerë.<sup>92</sup> Artikulli shoqërohej me fotografi të letrave që i akuzuari i kishte dërguar gjyqtarit hetues, si dhe një përmbledhje të deklaratave të gruas dhe mjekut të të akzuarit. Pjesa më e madhe e këtij informacioni u mbulua nga sekreti i hetimeve penale dhe gazetari u gjobit me 4,000 franga zvicerane.

Duke mbajtur qëndrimin se dënimi nuk shkelte të drejtën e lirisë së shprehjes, Gjykata konsideroi se informacioni në fjalë ishte shumë personal në natyrë, një pjesë e të cilit mjekësor. Gjykata deklaroi se ky lloj materiali meriton “nivelin më të lartë të mbrojtjes sipas Nenit 8”.<sup>93</sup> Gjykata gjithashtu mori në konsideratë një hulumtim që tregoi se zbulimi i informacionit të mbuluar nga sekreti i hetimeve gjyqësore është një vepër penale në të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës; se i akuzuari nuk ishte një figurë publike; dhe se dënimi i vendosur ishte proporcional (gjoba në fakt ishte paguar nga punëdhënësi i gazetarit).<sup>94</sup>

---

<sup>89</sup> [Stoll k. Zvicrës \[GC\]](#), kërkesa nr. 69698/01, aktgjykimi i datës 10 dhjetor 2007, paragrafi 39, dhe riafirmimi [Goodwin k. Mbretërisë së Bashkuar](#), kërkesa nr. 17488/90, aktgjykimi i datës 27 mars 1996, paragrafi 39.

<sup>90</sup> Shih diskutimin e Gjykatës mbi jurisprudencën në rastin [Alpha Doryforiki Tileorasi Anonymi Etairia k. Greqisë](#), kërkesa nr. 72562/10, aktgjykimi i datës 22 shkurt 2018, paragrafi 59-69.

<sup>91</sup> *Po aty.*, paragrafi 60.

<sup>92</sup> [Bédat k. Zvicrës](#), kërkesa nr. 56925/08, aktgjykimi i datës 29 mars 2016.

<sup>93</sup> *Po aty.*, paragrafi 76.

<sup>94</sup> *Po aty.*, paragrafi 76-82 dhe jurisprudenca e diskutuar aty.



## ii. Mbrojtja e dokumenteve konfidenciale shtetërore

Rasti i [Stoll k. Zvicrës](#) kishte të bënte me një gazetar i cili ishte gjobitur për publikimin e një raporti konfidencial të Ambasadorit Zviceran në Shtetet e Bashkuara në lidhje me strategjinë që do të miratohej nga Qeveria Zvicerane në negociatat midis, ndër të tjera, Kongresit Botëror Hebraik dhe bankave zvicerane në lidhje me kompensimin për viktimat e Holokaustit.<sup>95</sup> Dhoma e Madhe e Gjykatës vendosi se, në parim, e drejta e lirisë së shprehjes mbronte publikimin e materialit konfidencial, kur publikimi i shërben interesit publik. Megjithatë, ajo konsideroi se zbulimi i fragmenteve nga raporti i Ambasadorit kishte gjasa të kishte pasoja negative në negociatat në të cilat ishte e angazhuar Zvicra, veçanërisht për shkak të mënyrës shumë sensacionaliste në të cilën ishin shkruar artikujt që shoqëronin zbulimin. Prandaj, duke marrë parasysh gjobën relativisht të lehtë që ishte vendosur, Gjykata nuk arriti në përfundimin se dënimi shkelte të drejtën e gazetarit për lirinë e shprehjes.

Rasti [Martin dhe të tjerë k. Francës](#)<sup>96</sup> kishte të bënte me dënimin e gazetarëve për publikimin e një draft-raporti zyrtar mbi keqmenaxhimin e fondeve i cili, si një dokument i papublikuar, ishte konfidencial. Gjykata vendosi që raporti ishte me interes të qartë publik dhe dënimi i gazetarëve shkelte të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes:

“[A]rtikujt në fjalë përmbanin informacione kryesisht mbi menaxhimin e fondeve publike nga disa politikanë dhe zyrtarë publikë vendas. Kjo ishte padyshim një temë me interes të përgjithshëm për komunitetin vendas, mbi të cilën aplikantët kishin të drejtë të informonin publikun përmes shtypit [dhe] popullsia vendase kishte të drejtë të informohej. [R]oli i gazetarëve hulumtues është pikërisht të informojnë dhe të njoftojnë publikun për fenomenet e padëshirueshme në shoqëri, sapo të kenë në zotërim informacione relevante”.<sup>97</sup>

## iii. Gazetarë që kërkojnë informacione të “rrjedhura”

Në rastin [Dammann k. Zvicrës](#), një gazetar ishte dënuar për marrjen e informacionit nga një punonjës në zyrën e prokurorit të shtetit, në shkelje të ligjit të sekreteve zyrtare, në lidhje me dënimet e mëparshme të individëve që ishin arrestuar për grabitje.<sup>98</sup> Edhe pse nuk e publikoi informacionin, ai i tregoi listën që i ishte dërguar një zyrtari policie dhe më pas u ndoq penalisht dhe u gjobit. Gjykata vendosi se ky dënim shkelti të drejtën për lirinë e shprehjes. Ndërsa në parim të dhënat që lidhen me të dhënat penale të një të dyshuari meritonin mbrojtje, disa nga informacionet mund të ishin marrë përmes domenit publik dhe nuk u ishte shkaktuar asnjë dëm të drejtave të personave në fjalë. Për më tepër, Gjykata theksoi se ajo që kishte rëndësi nuk ishte nëse dënimi i dhënë gazetarit kishte qenë i ashpër, por që ai ishte dënuar fare: kjo “përbënte një lloj censure që tentonte ta inkurajonte atë të mos angazhohej në aktivitete kërkimore, të natyrshme për profesionin e tij, me qëllim përgatitjen dhe mbështetjen e një artikulli shtypi mbi një temë aktuale” dhe “rrezikon të dekurajojë gazetarët nga kontributi në diskutimin publik të

<sup>95</sup> [Stoll k. Zvicrës](#), kërkesa nr. 69698/01, aktgjykimi i datës 10 dhjetor 2007.

<sup>96</sup> [Martin dhe të tjerë k. Francës](#), kërkesa nr. 30002/08, aktgjykimi i 12 prillit 2012.

<sup>97</sup> [Martin dhe të tjerë k. Francës](#), kërkesa nr. 30002/08, aktgjykimi i 12 prill 2012, parag. 79 dhe 80.

<sup>98</sup> [Dammann k. Zvicrës](#), kërkesa nr. 77551/01, aktgjykimi i datës 25 prill 2006.

çështjeve që kanë të bëjnë me jetën e komunitetit”.<sup>99</sup> Gjykata përsëriti se kufizime të tilla “ka të ngjarë të pengojnë shtypin në kryerjen e detyrës së tij të informacionit dhe kontrollit”.<sup>100</sup>

**Pikat kryesore:**

- Informacioni "konfidencial" mund të ketë të bëjë me informacionin që është privat në natyrë, informacionin me natyrë tregtare, informacionin që ka të bëjë me sekretet shtetërore ose informacionin që ka të bëjë me hetimet dhe procedurat në hetimet dhe procedurat gjyqësore. Ligji i të drejtave të njeriut mundëson penalizimin e "rrjedhjes" ose publikimit të këtyre llojeve të informacionit, në varësi të kërkesave të përgjithshme të përmbajtjes, qartësisë në ligj dhe proporcionalitetit të përcaktuara në Seksionin 3 të këtij Udhëzuesi.
- Megjithatë, Gjykata ka deklaruar se natyra e interesit publik të informacionit në fjalë është me rëndësi të madhe

## VII. Penalizimi i fjalës që rrezikon sigurinë kombëtare dhe rendin publik

Mbrojtja e sigurisë kombëtare dhe rendit publik pranohet pa asnjë dyshim si një fushë legjitime për përdorimin e së drejtës penale. Megjithatë, për shkak se sanksionet e disponueshme sipas ligjeve të sigurisë kombëtare kanë tendencë të jenë të ashpra, Gjykata Evropiane ka paralajmëruar se ligjet që kufizojnë lirinë e shprehjes për arsye të sigurisë kombëtare duhet të përcaktojnë përkufizime të qarta dhe të sakta, në mënyrë që të mbrohen nga abuzimi.<sup>101</sup> Kërkesat për kufizim, qartësi të ligjit dhe proporcionalitet në mënyrën se si përdoret ligji, të përcaktuara në Seksionin 3, janë veçanërisht të rëndësishme në lidhje me rastet e sigurisë kombëtare.

Gjykata ka paralajmëruar kundër përdorimit joproporcional të ligjeve të sigurisë kombëtare, duke përfshirë disa raste kur nuk ishte e qartë nëse bëhet fjalë për ndonjë interes të sigurisë kombëtare. Për shembull, në rastin [Rotaru k. Rumanisë](#), Gjykata vuri në dukje se kishte “dyshime në lidhje me rëndësinë e informacionit për sigurinë kombëtare” dhe gjeti shkelje të të drejtave të aplikantit.<sup>102</sup> Gjykata ka paralajmëruar kundër përdorimit të ligjeve të sigurisë kombëtare edhe në situata konflikti të armatosur. Ndërsa theksoi se media nuk duhet të përdoret si zëdhënës i avokatëve të dhunës, ajo gjithashtu vendosi që shtetet "nuk munden, në lidhje me mbrojtjen e integritetit territorial ose sigurisë kombëtare ose parandalimin e krimit ose trazirave, të kufizojnë të drejtën e publikut për t'u informuar duke e sjellë peshën e ligjit penal mbi median".<sup>103</sup> Ngjashëm, në rastin [Selahattin Demirtaş k. Turqisë \(nr. 2\)](#), Gjykata vendosi se kërkohen prova konkrete për të demonstruar një lidhje midis ushtrimit të lirisë së shprehjes dhe anëtarësimit në një organizatë të armatosur terroriste.<sup>104</sup>

Në rastin [Gaponenko k. Letonisë](#), që kishte të bënte me arrestimin dhe ndalimin e një të dyshuari si “propagandist i Kremlinit” për një seri postimesh në Facebook në të cilat ai fliste për NATO-n, politikën gjuhësore në Letoni dhe pakicën ruse në Letoni, me akuza se prania e NATO-s në Letoni

<sup>99</sup> Po aty., parag. 57.

<sup>100</sup> Po aty.

<sup>101</sup> Shih, për shembull, [Klass dhe të tjerë k. Gjermanisë](#), kërkesa nr. 5029/71, aktgjykim i datës 6 shtator 1978.

<sup>102</sup> [Rotaru k. Rumanisë](#), kërkesa nr. 28341/95, aktgjykim i datës 4 maj 2000, parag. 53.

<sup>103</sup> [Erdogdu dhe Ince k. Turqisë](#), kërkesa nr. 25067/94 dhe 25068/94, aktgjykim i 8 korrikut 1999, parag. 54.

<sup>104</sup> [Selahattin Demirtaş k. Turqisë \(nr. 2\)](#), kërkesa nr. 14305/17, aktgjykim i 22 dhjetorit 2020, parag. 280.

ishite për të frikësuar rusofonët dhe kërcënime për luftë bërthamore në territorin letonez, Gjykata theksoi se:

“Një nga karakteristikat kryesore të demokracisë është mundësia që ajo ofron për zgjidhjen e problemeve përmes debatit publik, dhe se çdo masë e marrë duhet të synojë mbrojtjen e rendit demokratik nga kërcënimet ndaj tij, dhe duhet të bëhet çdo përpjekje për të mbrojtur vlerat e një shoqërie demokratike, siç janë pluralizmi, toleranca dhe mendjegjerësia”.<sup>105</sup>

Gjykata vazhdoi më tutje duke theksuar se:

“Kritikat ndaj qeverive dhe publikimi i informacionit që nga udhëheqësit e një vendi konsiderohet si rrezikim i interesave kombëtare nuk duhet, si rregull, të tërheqin akuza penale për vepra penale veçanërisht të rënda, siç janë përkatësia ose ndihma ndaj një organizate terroriste, përpjekja për të përmbysur qeverinë ose rendin kushtetues ose përhapja e propagandës terroriste”.<sup>106</sup>

Raste të tilla nënkuptojnë që shtetet nuk mund thjesht të shënojnë (tick) kutinë “siguria kombëtare” ose “rendi publik” për të legjitimuar përdorimin e sanksioneve. Ndërkohë që shteteve u lihet njëfarë lirie vlerësimi në lidhje me çështjet e sigurisë kombëtare, Gjykata ka vendosur se duhet të përcaktohet nëse zbulimi i informacionit është i aftë të shkaktojë "dëm të konsiderueshëm" për sigurinë kombëtare.<sup>107</sup>

Gjykata ka paralajmëruar gjithashtu kundër abuzimit me ligjet e sigurisë kombëtare. Për shembull, në rastin [Faruk Temel k. Turqisë](#), Gjykata konstatoi shkelje të së drejtës së lirisë së shprehjes ku kryetari i një partie politike të ligjshme ishte dënuar për kritikimin e ndërhyrjes së Shteteve të Bashkuara në Irak, izolimin e udhëheqësit të një organizate terroriste dhe kishte kritikuar zhdukjen e personave të marrë në paraburgim nga policia.<sup>108</sup> Gjykata theksoi se aplikanti kishte folur si anëtar i një partie politike opozitare, duke paraqitur pikëpamjet e partisë së tij mbi çështje aktuale me interes të përgjithshëm, dhe se ai nuk i kishte nxitur të tjerët për dhunë, rezistencë të armatosur ose kryengritje.<sup>109</sup> Në rastin [Fatullayev k. Azerbajxhanit](#), Gjykata konstatoi se gjykatat vendase “zbatuan në mënyrë arbitrare dispozitat penale mbi terrorizmin në rastin konkret” dhe theksoi se “[n]dërhyrja e tillë arbitrare në lirinë e shprehjes, e cila është një

---

<sup>105</sup> [Gaponenko k. Letonisë](#), (vend.), kërkesa nr. 30237/18, aktgjykimi i datës 23 maj 2023 (vend.), paragrafi 42.

<sup>106</sup> *Po aty*. Pas shqyrtimit të hollësishëm të fakteve, Gjykata arriti në përfundimin se arrestimi dhe ndalimi i aplikantit nuk shkelte të drejtën e tij për lirinë e shprehjes.

<sup>107</sup> Shih, për shembull, [Gîrleanu k. Rumanisë](#), kërkesa nr. 50376/09, aktgjykimi i datës 26 qershor 2018, paragrafi 89, dhe rastet e diskutuara në të.

<sup>108</sup> [Faruk Temel k. Turqisë](#), kërkesa nr. 16853/05, aktgjykimi i datës 1 shkurt 2011.

<sup>109</sup> *Po aty.*, paragrafi 58-64.

nga liritë themelore që shërben si themel i një shoqërie demokratike, nuk duhet të ndodhë në një shtet të qeverisur nga sundimi i ligjit.”<sup>110</sup>

**Pikat kryesore:**

- Mbrojtja e sigurisë kombëtare dhe rendit publik pranohet pa asnjë dyshim si një fushë legjitime për përdorimin e së drejtës penale. Megjithatë, për shkak se sanksionet e disponueshme sipas ligjeve të sigurisë kombëtare kanë tendencë të jenë të ashpra, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka paralajmëruar se ligjet që kufizojnë lirinë e shprehjes për arsye të sigurisë kombëtare duhet të përcaktojnë përkufizime të qarta dhe të sakta, në mënyrë që të mbrohen nga abuzimi. Kërkesat për kufizim, qartësi të ligjit dhe proporcionalitet në mënyrën se si përdoret ligji, të përcaktuara në Seksionin 3, janë veçanërisht të rëndësishme në lidhje me rastet e sigurisë kombëtare.
- Gjykata ka paralajmëruar kundër përdorimit joproporcional të ligjeve të sigurisë kombëtare, duke përfshirë disa raste kur nuk ishte e qartë nëse bëhet fjalë për ndonjë interes të sigurisë kombëtare, madje në situata të konfliktit të armatosur.
- Kjo do të nënkuptojë që shtetet nuk mund thjesht të shënojnë (tick) kutinë “siguria kombëtare” ose “rendi publik” për të legjitimuar përdorimin e sanksioneve. Ndërkohë që shteteve u lihet njëfarë lirie vlerësimi në lidhje me çështjet e sigurisë kombëtare, Gjykata ka vendosur se duhet të përcaktohet nëse zbulimi i informacionit është i aftë të shkaktojë “dëm të konsiderueshëm” për sigurinë kombëtare.

### **VIII. Penalizimi i publikimit të “dezinformimit”**

Ndërsa problemi i të ashtuquajturit “dezinformim”<sup>111</sup> është një çështje shqetësimi të përbashkët dhe objekt i shumë debateve midis politikëbërësve, ligji evropian i të drejtave të njeriut ka mbajtur vazhdimisht qëndrimin se penalizimi i gjerë i çdo informacioni që mund të etiketohet si i tillë nuk është as proporcional dhe as nuk ka gjasa të jetë një përgjigje efektive..<sup>112</sup>

Ndërkohë që Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk ka dëgjuar asnjë rast “dezinformimi” si të tillë, ajo ka dëgjuar disa raste në të cilat shtetet kanë sanksionuar median dhe të tjerët për publikimin e informacionit, vërtetësia e të cilit nuk mund të përcaktohet. Gjykata ka kërkuar përmbajtje në penalizimin e çdo publikimi të tillë. Në rastin [Salov k. Ukrainës](#), që kishte të bënte me një fletëpalosje që i atribuonte në mënyrë të rreme disa deklaratat një kandidati presidencial, Gjykata theksoi:

“Neni 10 nuk ndalon diskutimin ose shpërndarjen e informacionit të marrë edhe nëse dyshohet fuqimisht se ky informacion mund të mos jetë i vërtetë. Të sugjerosh të

<sup>110</sup> [Fatullayev k. Azerbajxhanit](#), kërkesa nr. 40984/07, aktgjykimi i 22 prill 2010, parag. 124.

<sup>111</sup> Nuk këshillohet përdorimi i termit “lajme të rreme”; Observatori Evropian Audiovizual argumenton se është një term i politizuar i përdorur nga disa për të veçuar organizatat e lajmeve me mbulimin e të cilave nuk pajtohen. Një grup ekspertësh të nivelit të lartë për lajmet e rreme dhe dezinformimin online, i ngritur nga Komisioni Evropian, e ka mbështetur këtë qasje, duke sugjeruar në vend të saj përdorimin e termit “dezinformim”. Shih Cabrera Blázquez F.J., Cappello M., Talavera Milla J., Valais S., (2022), *Fuqizimi i përdoruesit kundër dezinformimit në internet*, Observatori Evropian Audiovizual, Strasburg, gjendet në:

<https://rm.coe.int/iris-plus-2022en3-user-empowerment-against-disinformation/1680a963c4>.

<sup>112</sup> Duhet theksuar se ka shumë ligje që tashmë trajtojnë përhapjen e informacionit të pavërtetë, siç janë ligjet për shpifjen dhe ligjet për mbrojtjen e konsumatorit. Ky seksion nuk merret me këto ligje, por diskuton atë që në diskursin popullor quhet lirshëm si “lajme të rreme” ose “dezinformim”.

kundërtën do t'i privonte personat nga e drejta për të shprehur pikëpamjet dhe opinionet e tyre rreth deklaratave të bëra në mediat masive dhe kështu do të vendoste një kufizim të paarsyeshëm të lirisë së shprehjes”.<sup>113</sup>

Ajo vendosi se dënimi i individit në fjalë shkelte të drejtën e lirisë së shprehjes, sepse nuk kishte prova se ai ishte përpjekur qëllimisht të mashtronte votuesit e tjerë ose të pengonte aftësinë e tyre për të votuar.

Gjykata ka theksuar gjithashtu rëndësinë e debatit të lirë dhe të hapur mbi çështjet e shkencës dhe shëndetit. Në rastin [Hertel k. Zvicrës](#), e cila kishte të bënte me një shkencëtar i cili kishte vënë në dukje rreziqet e mundshme shëndetësore që lidhen me gatimin e ushqimit në furrat me mikrovalë, Gjykata vendosi:

“Nuk ka shumë rëndësi që mendimi i tij është një mendim minoritar dhe mund të duket i pavlerë, pasi që, në një sferë në të cilën nuk ka gjasa të ekzistojë ndonjë siguri, do të ishte veçanërisht e paarsyeshme të kufizohej liria e shprehjes vetëm në idetë e pranuar përgjithësisht”.<sup>114</sup>

I vetmi skenar në të cilin dezinformimi mund të penalizohet është kur publikimi i tij rezulton në një rrezik të qartë për sigurinë kombëtare, rendin publik ose një interes tjetër legjitim të përmendur në Nenin 10(2), dhe përdorimi i ligjit penal është një përgjigje e nevojshme dhe proporcionale. Për shembull, në rastin [Gaponenko k. Letonisë](#) Gjykata vendosi që arrestimi dhe ndalimi i një individit të akuzuar për përhapje propagande ishte një përgjigje e nevojshme në dritën e situatës së tensionuar të sigurisë në vend.<sup>115</sup> Ekziston gjithashtu një lidhje e qartë midis dezinformimit dhe gjuhës së urrejtjes; në fakt, përhapja e dezinformimit është treguar të jetë një mjet kyç për nxitjen e urrejtjes.<sup>116</sup> Në raste të tilla, dezinformimi mund të penalizohet, jo sepse është i rremë, por për shkak të urrejtjes ndaj të cilës ai nxit.

Komisioni i Venecias ka paralajmëruar se masat e rrepta kundër dezinformimit mund të çojnë në censurë dhe kufizime mbi përmbajtjen legjitime. Në një Opinion të Përbashkët urgjent mbi projekt-amendamentet në Kodin Penal të Turqisë në lidhje me "Informacionin e Rremë ose Mashtrues", është theksuar se penalizimi është thellësisht problematik: “Historia është e mbushur me shembuj të regjimeve që zbatojnë dispozita penale për të shtypur mospajtimin dhe kritikën, duke përfshirë edhe kundër gazetarëve dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut.”<sup>117</sup> Komisioni i Venecias ka mbështetur gjithashtu Deklaratën e Përbashkët të Mandateve të Posaçme mbi Lirinë e Shprehjes dhe “Lajmet e Rreme”, Dezinformimin dhe Propagandën,<sup>118</sup> e cila thotë se “ndalimet e përgjithshme për shpërndarjen e informacionit bazuar në ide të paqarta dhe dykuptimëshe, duke përfshirë “lajmet e rreme” ose 'informacionin jo objektiv', janë të

<sup>113</sup> [Salov k. Ukrainës](#), kërkesa nr. 65518/01, aktgjykimi i datës 6 shtator 2005, paragrafi 113.

<sup>114</sup> [Hertel k. Zvicrës](#), kërkesa nr. 25181/94, aktgjykimi i 25 gushtit 1998, paragrafi 50.

<sup>115</sup> [Gaponenko k. Letonisë](#), (vend.), kërkesa nr. 30237/18, aktgjykimi i datës 23 maj 2023.

<sup>116</sup> Siç është vënë re ndër të tjera, në rastin [Raporti i Raportuesit Special mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës së lirisë së mendimit dhe shprehjes](#), A/HRC/47/25, 2021, paragrafi 22-29.

<sup>117</sup> Komisioni i Venecias, [Opinion nr. 1102 / 2022](#), 7 tetor 2022, f. 11 (duke cituar me miratim analizën e ish-Raportuesit Special të OKB-së për Lirinë e Shprehjes David Kay, Policia e Fjalës: Lufta Globale për të Administruar Internetin. Columbia Global Reports, 3 qershor 2019, f. 94).

<sup>118</sup> Raportuesi Special i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Lirinë e Opinioneve dhe Shprehjes, Përfaqësuesi i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë për Lirinë e Medias, Raportuesi Special i Organizatës së Shteteve Amerikane për Lirinë e Shprehjes dhe Raportuesi Special i Komisionit Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe të Popullit për Lirinë e Shprehjes dhe Qasjen në Informacion, [Deklarata e Përbashkët mbi Lirinë e Shprehjes dhe “Lajmet e Rreme”, Dezinformimin dhe Propagandën](#), (FOM.GAL/3/17), 3 mars 2017.

papajtueshme me standardet ndërkombëtare për kufizimet e lirisë së shprehjes (...) dhe duhet të shfuqizohen”.<sup>119</sup>

Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës ka pranuar se dezinformimi minon besimin në media dhe kërcënon besueshmërinë e informacionit që ushqen debatin publik dhe mundëson demokracinë. Megjithatë, në vend që të penalizojë dezinformimin, ajo ka nxjerrë në pah masa të tilla si promovimi i gazetarisë cilësore, ofrimi i mbështetjes për verifikimin e fakteve, rëndësia e fuqizimit të përdoruesve dhe zgjidhjet për hartimin e platformave.<sup>120</sup>

## **IX. Roli i Këshillit të Evropës në mbështetjen e institucioneve vendase dhe organizatave të shoqërisë civile**

### **Pikat kryesore:**

- Ndërsa problemi i të ashtuquajturit “dezinformim” është një çështje shqetësimi të përbashkët dhe objekt i shumë debateve midis politikëbërësve, ligji evropian i të drejtave të njeriut ka mbajtur vazhdimisht qëndrimin se penalizimi i gjerë i çdo informacioni që mund të etiketohet si i tillë nuk është as proporcional dhe as nuk ka gjasa të jetë një përgjigje efektive..
- I vetmi skenar në të cilin dezinformimi mund të penalizohet është kur publikimi i tij rezulton në një rrezik të qartë për sigurinë kombëtare, rendin publik ose një interes tjetër legjitim të përmendur në Nenin 10(2), dhe përdorimi i ligjit penal është një përgjigje e nevojshme dhe proporcionale.
- Komisioni i Venecias ka paralajmëruar se masat e rrepta kundër dezinformimit mund të çojnë në censurë dhe kufizime mbi përmbajtjen legjitime.
- Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës ka pranuar se dezinformimi minon besimin në media dhe kërcënon besueshmërinë e informacionit që ushqen debatin publik dhe mundëson demokracinë. Megjithatë, në vend që të penalizojë dezinformimin, ajo ka theksuar masa të tilla si promovimi i gazetarisë cilësore, ofrimi i mbështetjes për verifikimin e fakteve, rëndësia e fuqizimit të përdoruesve dhe zgjidhjet për hartimin e

Misioni i Këshillit të Evropës është të promovojë dhe mbrojë të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit në të gjitha shtetet anëtare të tij<sup>121</sup>. Shtyllat kryesore të punës së tij përfshijnë

<sup>119</sup> Komisioni i Venecias, [Raporti i Përbashkët i Komisionit të Venecias dhe i Drejtorisë së Shoqërisë së Informacionit dhe Veprimet Kundër Krimit të Drejtorisë së Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit \(DGI\), mbi Teknologjitë Dixhitale dhe Zgjidhjet](#), CDL-AD(2019)016, parag. 90.

<sup>120</sup> [Rekomandimi CM/Rec\(2022\)4 mbi promovimin e një mjedisi të favorshëm për gazetari cilësorë në epokën dixhitale](#), i miratuar më 17 mars 2022; [Rekomandimi CM/Rec\(2022\)12 mbi komunikimin zgjedhor dhe mbulimin mediatik të fushatave zgjedhore](#), i miratuar më 6 prill 2022. Në dhjetor 2023, Komiteti Drejtues i Këshillit të Evropës për Median dhe Shoqërinë e Informacionit miratoi një Shënim Udhëzues i cili sugjeron hapa të ndryshëm praktikë që shtetet duhet të ndërmarrin për të luftuar përhapjen e keqinformimit dhe dezinformimit në internet përmes verifikimit të fakteve dhe zgjidhjeve të dizajnit të platformave në një mënyrë që përputhet me të drejtat e njeriut. [Shënim Udhëzues mbi luftimin e përhapjes së informacioneve të gabuara dhe dezinformimit në internet përmes verifikimit të fakteve dhe zgjidhjeve të dizajnit të platformave në një mënyrë në përputhje me të drejtat e njeriut](#), i miratuar nga Komiteti Drejtues për Median dhe Shoqërinë e Informacionit (CDMSI) në takimin e tij të 24-të, 29 nëntor - 1 dhjetor 2023.

<sup>121</sup> Këshilli i Evropës është organizata udhëheqëse e kontinentit për të drejtat e njeriut. Ai përbëhet nga 46 shtete anëtare, duke i përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i projektuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut,

mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut; forcimin e institucioneve dhe praktikave demokratike; promovimin e sundimit të ligjit; ndërtimin e një shoqërie kohezive dhe gjithëpërfshirëse; dhe promovimin e bashkëpunimit kulturor.

Promovimi i respektit për të drejtën e lirisë së shprehjes përfshin disa nga këto shtylla dhe përqendrohet në sigurimin e ekuilibrit të duhur midis respektit për lirinë e shprehjes dhe gëzimit të të drejtave të tjera të njeriut. Për këtë qëllim, Këshilli i Evropës vendos standarde, monitoron përputhshmërinë me to dhe punon me shtetet dhe shoqërinë civile për të përmirësuar zbatimin e tyre në nivel vendas.

Kjo punë është me rëndësi të veçantë në dritën e ndryshimeve dinamike dhe të vazhdueshme në peizazhin mediatik, të cilat kanë sjellë ndryshime rrënjësore në natyrën e "publikimit" dhe kuptimin e "medias". Në peizazhin mediatik të sotëm, një "influencues" individual që publikon përmes platformave të mediave sociale mund të arrijë miliona, ndërsa disa gazeta kanë një shtrirje vetëm prej disa qindrash, duke përmbysur kështu nocionet tradicionale të rregullimit të medias. Siç njihet nga Gjykata:

"Aktiviteti shprehës i gjeneruar nga përdoruesit në internet ofron një platformë të paparë për ushtrimin e lirisë së shprehjes [...]. Krahas këtyre përfitimeve, mund të lindin edhe rreziqe të caktuara. Shpifja dhe llojet e tjera të gjuhës qartësisht të paligjshme, duke përfshirë gjuhën e urrejtjes dhe gjuhën që nxit dhunën, mund të përhapen si kurrë më parë, në të gjithë botën, brenda pak sekondash, dhe ndonjëherë mbeten vazhdimisht të disponueshme në internet".<sup>122</sup>

Këto rreziqe kërkojnë modele të reja vetërregulluese, bashkërregulluese dhe rregullatore që mbulojnë mediat e reja, aktorët e rinj dhe sfidat e reja. Përmes jurisprudencës së Gjykatës dhe përcaktimit të standardeve të promovuara nga Komiteti Drejtues për Lirinë e Shprehjes në Media dhe Shoqërinë e Informacionit, nën përgjegjësinë e përgjithshme të Komitetit të Ministrave, Këshilli i Evropës udhëzon shtetet anëtare në përmbushjen e detyrimit të tyre për t'u përmbajtur nga shkelja e të drejtës së lirisë së shprehjes dhe të drejtave të tjera të njeriut në mjedisin dixhital. Ata gjithashtu kanë një detyrim pozitiv për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe për të krijuar një mjedis të sigurt dhe të mundshëm për të gjithë që të marrin pjesë në debatin publik dhe të shprehin mendime dhe ide pa frikë, duke përfshirë ato që ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë zyrtarët shtetërorë ose çdo sektor të popullsisë.<sup>123</sup>

Përmes programeve të tij të bashkëpunimit, Këshilli i Evropës ofron ndihmë teknike të bazuar në kërkesë për institucionet vendase dhe organizatat e shoqërisë civile për të përmirësuar kapacitetet e tyre në zbatimin e standardeve ekzistuese mbi lirinë e shprehjes dhe median, me objektivin kryesor për të siguruar që liria e shprehjes të ruhet, promovohet dhe ushtrohet me përgjegjësi. Ekspertiza, baza e vlerës së shtuar të projekteve të bashkëpunimit, vjen nga shërbimet përkatëse në të gjithë Organizatën. Zbatimi i projektit mund të përfshijë vlerësime të nevojave, ekspertizë në politika dhe ligjore, ndërtim kapacitetesh për një gamë të gjerë institucioneve dhe aktorësh vendas, si dhe rritje të ndërgjegjësimit dhe shqyrtime nga kolegët.

---

demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

<sup>122</sup> [Delfi AS k. Estonisë \[GC\]](#), kërkesa nr. 64569/09, aktgjykimi i 16 qershorit 2015.

<sup>123</sup> [Rekomandimi CM/Rec\(2018\)2 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për rolet dhe përgjegjësitë e ndërmjetësve të internetit](#).



Ky përkthim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Këshillit të Evropës dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur diversitetin kulturor, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t'i ndajë arritet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

[www.europa.eu](http://www.europa.eu).

[www.europa.eu](http://www.europa.eu)

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

[www.coe.int](http://www.coe.int)

Përkthimi është bashkëfinancuar  
nga Bashkimi Evropian

